

E PËRDITSHME
E PAVARUR

Drejtor:
FAHRI BALLIU
Kryeredaktor:
ILIR NIKOLLA

Nr. 51 (4476)
Viti XV i botimit
(numri i parë doli
më 18.10.1997)

E enjte,
24 shkurt 2011

55

Adresa: Rruga
"Medar Shtylla",
qendra e biznesit

Tel: 04/2321364,
Tel: 04/2321366,
Fax: 04/2321365,
Tiranë
E-mail:
info@gazeta55.net,
gazeta55mail@
yahoo.com,
Internet:

www.gazeta55.al
Çmimi 30 lekë
Greqi 1,5 EURO

DITA/19

Serbët, sërish protagonistë të gjenocideve – mercenarët serbë të luftës në mbrojtje të Gadafit

■ Nga Redi Agolli

"Qentë e luftës", kështu quhet organizata e mercenarëve serbë të luftës, të cilët aktualisht kanë udhëtuar në Libi për të ndihmuar, në këmbim të mijëra dollarëve, liderin libian, Muammar al Gaddafi, për të kryer të vetmen punë që ata dinë të bëjnë më mirë, atë të vrasjes dhe terrorizimit të njerëzve të pafajshëm. Ata kanë dhënë provat për aftësinë e tyre, në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë...

SHBA sanksionon 8 majin, fshikullon bojkotin e Ramës

Thërrmohen shpresat e opozitës për shtyrje të zgjedhjeve vendore dhe nisjen e një negociate politike që do t'ia jepte Edvinit pushtetin në tavolinë. Ambasadori amerikan Arvizu u ka bërë thirrje qytetarëve të përfshihen në organizimin e zgjedhjeve të 8 majit. Me mesazhin se Shqipëria është vend i stabilizuar dhe përpjekja për destabilizimin e zgjedhjeve dhe të institucioneve do të ndëshkohet, vjen në Tiranë edhe zëvendësi i sekretares së Shtetit, Hillari Klinton, Xhejms Shtajnberg

NË BRENDËSI

Topalli: "Në një vend demokratik, zgjedhjet s'mund t'i bllokojë askush"

Kryeparlamentarja i tregon së majtës vetëm një rrugë shpëtimi, zbatimin e kushtetutës

"Të shmangët korrupsioni në emërimet e gjyqtarëve"

Kryeministri Sali Berisha bën thirrje sërish për reformë në drejtësi, si e vetmja mënyrë për të luftuar korrupsionin endemik në pushtetin e qeverisur nga kreu i shtetit

POLITIKË

Bamir Topi nuk është garant i kushtetutës, por garant i Puçit

■ Nga Fahri Balliu

Dje, presidenti në detyrë Bamir Topi lëshoi një deklaratë politike, si thirrje për kryetarët e partive, lidhur me situatën. Në radhë të parë, deklarata ishte krejt në një stil tjetër, krahasuar me deklaratat e tjera të publikuara prej tij. Nga stilemat, ligjërimi është shumë i ngjashëm me formulimet gjuhësore e stilistike të Edi Ramës. Kjo mund të vijë edhe nga karakteri i thellë marksist i deklaratës, veçse, që në këtë rast duhet kuptuar si një rregullsi formale nga ana propagandistike. Por, më shumë se stilemat, këtë deklaratë e ka qarë së shkruari vërtet Edi Rama, përse i përket formulimit të saj politik. Presidenti është komplet në pozitën e strucit, ai nuk gjen asgjëkund rolin e tij të vërtetë, atë që përbën fajësi absolute të tij. Ky njeri ka një muaj që hesht për institucionet, për dhunën ndaj tyre. Në fillim, dukej se fajësia e tij qëndronte vetëm tek fakti i indiferencës së tij, i mediokritetit politik, apo më saktë i mungesës së thellësisë dhe të thellimit në kryerjen e detyrës. Por, në një analizë më të thellë, dhe sigurisht me



DOSSIER/16-17

60 vjet nga hedhja e bombës në Legatën Sovjetike në Tiranë

Terrorizmi i pushtetit mbi qytetarët shqiptarë

Në vitet e para të demokracisë, ndër të tjera nisi edhe një proces që synonte rehabilitimin e viktimeve të diktaturës komuniste. Në njërin prej rasteve të shumta të zbulimit të krimeve të diktaturës,



FORUM

Edhe në valë bojkoti, s'ndalet lufta e brendshme e PS-së për thelat e bashkive

Redaksionale

Nëse "qeveria vret shqiptarët me kequshqyerje", për ekuilibër substancial, Erjon Braçe i vret shqiptarët me demagogji infantile. Rikthimi i deputetit të Beratit në konferenca për shtyp të Partisë Socialiste dëshmon sakaq për nisjen e fushatës elektorale nga ana e opozitës së bashkuar. Dhe për sefte PS-ja kishte si një plan "A", po ashtu dhe një plan "B". Plani i parë synonte ta kthente komisio

Ju tregoj përvojën time në fushëbetejën e Afganistanit

Nga Stanley A. McChrystal (Foreign Policy)

Nga fillimi i komandës time në Afganistan, dy ose tre herë në javë, i shoqëruar nga pak ndihmës dhe shpesh nga homologët e mi afganë, unë do të lë selinë e Forcës së Ndihmës të Sigurisë Ndërkom-bëtare në Kabul e do të udhëtoj përmes Afganistanit – nga qytetet kritike si Kandahari deri tek vendet më të largëta në rajonet kufitare të dhunshme. Ne do nisemi

LISTA E PLOTË

Qeveria miraton fondin prej 1.36 miliardë lekë, për dëmshpërblimin e 455 ish-të dënuarve politikë

Albanian Airlines
www.albanianair.com

Bamir Topi nuk është garant i Kushtetutës, por garant i Puçit

Nga Fahri Balliu

Dje, presidenti në detyrë Bamir Topi lëshoi një deklaratë politike, si thirrje për kryetarët e partive, lidhur me situatën. Në radhë të parë, deklarata ishte krejt në një stil tjetër, krahasuar me deklaratat e tjera të publikuara prej tij. Nga stilemat, ligjërimi është shumë i ngjashëm me formulimet gjuhësore e stilistike të Edi Ramës. Kjo mund të vijë edhe nga karakteri i thellë marksist i deklaratës, veçse, që në këtë rast duhet kuptuar si një rregullsi formale nga ana propagandistike. Por, më shumë se stilemat, këtë deklaratë e ka qarë së shkruari vërtet Edi Rama, përse i përket formulimit të saj politik. Presidenti është komplet në pozitën e strucit, ai nuk gjen asgjëkund rolin e tij të vërtetë, atë që përbën fajësi absolute të tij. Ky njeri ka një muaj që hesht për institucionet, për dhunën ndaj tyre. Në fillim, dukej se fajësia e tij qëndronte vetëm tek fakti i indiferencës së tij, i mediokritetit politik, apo më saktë i mungesës së thellësisë dhe të thellimit në kryerjen e detyrës. Por, në një analizë më të thellë, dhe sigurisht me një informacion po kaq të thellë, zotëria në fjalë nuk fsheh dot implikimin e tij në anën e Edi Ramës,



jo thjesht si një ushtar, por si një garant jo i kushtetutës, por i puçit.

Edhe ato që ka deklaruar Bamir Topi në televizion, të gënjeshtërtat apo të vërtetata qofshin, nuk e shpëtojnë kursesi atë tashmë nga leximi i hapur i rolit të tij „pro“ Edi Ramës. Edhe një qytetar i thjeshtë, që shëtit përpara Pallatit të Kongreseve, para disa ditësh, e cilësonte Topin si gjeneratorin dhe frymëzimin e puçit. Dhe kur mbërrin kjo në nivelin e qytetarit të thjeshtë, mendo se ç'dinë ata që

merren me këtë punë. Je ti zoti Topi paralizuesi i institucioneve kushtetuese, që ditën e 21 janarit bënin çdo gjë, madje edhe korrupsion, madje edhe banket, por nuk bënin detyrën. Je ti zoti Topi, frymëzuesi i Edi Ramës, garantuesi i bolshevizmit të tij anarkisto-enverist, je ti zoti Topi, që paaftësinë apo rëndomtësinë juridike të prokurores e ke shndërruar në një qëndrim antikushtetues dhe e ke rënditur atë në një mënyrë staliniste, që edhe Vishinski do ia kish-

te zili në mbrojtje të kriminelëve. Je ti zoti Topi, që si president, as ke kërkuar dhe as ke interpretuar ndonjë të dhënë të shërbimit sekret shqiptar, lidhur me 21 janarin. Në fakt ti edhe i ke bërë disa takime me ndërkombëtarët, por në ndonjë rast s'e ke frenuar veten dhe s'ke mundur ta fshehësh dëshirën tënde për zgjedhje të përgjithshme, jo për zgjedhje lokale. Ti u ke lexuar ndërkombëtarëve edhe parullat e protestuesve të Ramës, ti ke harxhuar energji të jashtëzakonshme për sulme dhe rrethim personal të njerëzve që s'janë dakord me ty. Të gjitha i ke bërë dhe të gjitha janë përgjegjësitë e tua.

Por ti kujton dhe më saktë, ti harron se s'ka gjë që s'dihet dhe minarja s'futet në thes. Ti zotëri, je i rënditur me Edi Ramën, me premtimin që ai të të japë një mandat të dytë, sepse ti mendoje se ky ka të ardhme si lider i majtë. Që këtu, ti ke tradhtuar interesat kombëtare, ke tradhtuar vetveten, dhe gjithçka që ti doje ta dinin dhe ta njihnin në popull. Sigurisht, je absolutisht i keqinformuar dhe ke gjykuar me një intuitë politike që të çon deri tek Fresku.

Prandaj, ti s'mund të bësh një deklaratë të ndershme, të vërtetë. Ti nuk i do zgjedhjet e 8 majit dhe ti s' thua asgjë për to në deklaratën tënde. Ti nuk thua asgjë për sab-

otimin që po u bën Rama zgjedhjeve, ti nuk thua asgjë për planin e zi të Ramës kundër KQZ-së dhe mosdorëzimit të emrave të KZAZ-ve. Kjo kërkonte deklaratë nga presidenti, jo qëndrimi tejet hipokrit i yti, që u flet të dyja palëve, sikur janë njësoj fajtorë. Si mundet të krahasosh dhe t'i bësh njësoj të dy palët. Ti e bën këtë, sepse je me njërin palë, je me palën që godet qeverinë e ligjshme, që urren institucionet që gjasme ti do t'i përfaqësosh. Ti edhe këtë deklaratë që ke lëshuar, për fat është aq e qartë si deklaratë në mbrojtje të PS-së, saqë bëre mirë që e le këtë dokument. Por ti këtë e lëshove meqë sot mbërrin zëvendësi i Hillari Klintonit, zot Shtajtnberg në Tiranë, dhe ti do t'i hedhësh hi syve me një copë letër të tillë. Dhe nga ana tjetër, dëshira jote për të marrë një rol ndërmjetës nuk mund të realizohet, se ti më mirë ndërmjetëso brenda PS-së për heqjen ose mbajtjen e Ramës, se për të tjerat s'të beson njeri.

Kështuqë deklarata, qoftë për stilemat e reja, merr përgjigjen e një anecdote. Për kuptimin, të gjithë shqiptarët e kanë të qartë se presidenti në detyrë Bamir Topi nuk ka asnjë kontakt dhe nuk gëzon asnjë besim, asnjë kredencial kushtetues për shkak se ka abuzuar dhe është gjeneratori i një puçi kushtetues.

Reagimi/PD, Bumçi: Bamir Topi të respektojë detyrimet kushtetuese "Ftesat s'janë të nevojshme, po pengohet hetimi i 21 janarit"

Partia Demokratike ka reaguar pas ftesës së presidentit të Republikës. Deputeti Aldo Bumçi tha dje për gazetën „55“, se, „ftesa të tilla nuk janë të nevojshme dhe i kërkoi kreu të shtetit të respektojë detyrimet kushtetuese“. „Ne e ftojmë presidentin e Republikës që të përbushë detyrën e tij Kushtetuese“, u shpreh deputeti dhe kreu i PD-së për degën e Tiranës, Aldo Bumçi. Ai tha gjithashtu se elementi të caktuar përfaqësues të institucioneve shtetërore tentuan të sabotojnë hetimet e dhunës së 21 janarit. „Hetimi i 21 janarit po pengohet nga 'shokët' dhe 'shoqet' e bulevardit“, tha Bumçi gjatë komentit të tij për gazetën „55“, menjëherë pas letrës së presidentit drejtuar forcave politike.

Kronika/Kreu i shtetit, letër partive për 8 majin, në asnjë rresht s'përmend shantazhin e PS-së

Presidenti i Republikës Bamir Topi u ka nisur dje partive politike nga një letër, për sa i përket zhvillimit të zgjedhjeve vendore të 8 majit si dhe situatës politike që po karakterizon muajt e parë të 2011-ës. Në letrën e tij, kreu i shtetit citon si të nevojshme fillimin e përgatitjeve për këtë proces elektoral, por në asnjë paragraf të dokumentit të firmosur prej tij, nuk i bëhet thirrje Partisë Socialiste që të heqë dorë nga metodika e bllokimit të institucioneve, me tendencë shtyrjen e zgjedhjeve vendore.

Për presidentin e Republikës s'përbën problem as fokusimi i linjës së shantazhit që PS dhe aleatët e saj kanë implementuar gjatë dy ditëve të fundit, me qëllim cenimin e pavarësisë së institucioneve të administrimit të votës dhe shtyrjen e zgjedhjeve vendore përtej 8 majit, çka përbën një shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe integritetit të kreu të shtetit, si dekretues i datës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Partia Socialiste është jashtë çdo afati ligjor lidhur me propozimin e anëtarëve në komisionet e Qendrave të Votimit (QV) si dhe

Fakti/Presidenti Bamir Topi i paqartë në rolin e tij si udhëheqës i institucionit të Presidentit

Në një kohë kur mazhoranca këmbëngul për hetimin e protestës së dhunshme të opozitës në 21 janar, kreu i shtetit duket se ka ndryshuar nga qëndrimi fillestar, atëherë kur për asnjë moment nuk dënoi revoltën e armatosur të opozitës. Në letrën, ku më shumë përqipet të intrigojë forcat politike dhe t'i largojë ato nga misioni parësor, ai i pjesëmarrjes në zgjedhjet e 8 maji, presidenti i republikës komplikon edhe më tej situatën përmes këtij standardi që ai aplikon, që do të thotë heshtje ndaj dhunës dhe demonstratës së armatosur, ndërsa aty ku është më e nevojshme rinisja e dialogut politik në dobi të parlamentarizmit dhe respektimit të kushtetutës së Shqipërisë, presidenti Topi përsëri tenton të fshihet nga misioni i tij si garant i ligjit themeltar. Për herë të parë që pas një muaji, kreu i shtetit pranon zyrtarisht se më 21 janar u shënuan akte dhune ndaj institucioneve të shtetit. Në deklaratat e tij të mëparshme, presidenti i Republikës e ka quajtur sulmin ndaj kryeministrit si „ngjarje në bulevard“ apo në rastin më të mirë, si „ngjarje tragjike“. Kjo letër e presidentit vjen menjëherë pas publikimit të njoftimit se dy zyrtarë të lartë amerikanë do të vizitohin Shqipërinë në përpjekje për të ndihmuar në kapërcimin e situatës. Për coincidençë apo jo, edhe kjo deklaratë e presidentit Topi përkon me vizitën e Zëvendësdihmëssekretarit amerikan të Shtetit, Thomas Countryman. Edhe në vizitën e tij të parë, 1 orë para mbërritjes së Countryman në Tiranë, presidenti doli në konferencë për shtyp dhe foli për ngjarjet e 21 janarit, por pa përmendur këtu dhunën ndaj institucioneve kushtetuese.

ato Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ), duke e detyruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të shpallë vendet vakante dhe plotësimin e kuorumit të nevojshëm vendimmarrës nga përfaqësues të shoqërisë civile, studentë, pedagogë dhe mësues.

Po ashtu, Presidenti i Republikës i referohet dhe ngjarjeve të dhunshme të 21 janarit, por kursesi s'guxon t'i konsiderojë ato si

dhunë ndaj institucioneve, dhunë që duhet dënuar si dhe përgjegjësit e organizatorët e saj të shkojnë përpara drejtësisë. Ai mjaftohet me togfjalëshin „bashkëfajësi“..., atëherë kur dihet se i kujt është faji që u ushtrua dhunë ndaj Këshillit të Ministrave.

Presidenti Topi, i kërkon partive politike të koncentrojnë një vullnet të përbashkët për arritjen e një zgjidhje afatgjatë.

Zgjidhje afatgjatë?

Por zgjedhjet zhvillohen pas 3 muajsh... Zgjidhja që duhet të arrijnë forcat politike duhet të përmblidhë kuadrin kushtetues të zhvillimit të zgjidhjes, si efekt i kushtëzuar nga ngushtimi i kohës dhe kursesi 'zgjidhja afatgjatë' që pretendon presidenti i Republikës, e cila më tepër duket si tendencë e një interesi personal-institucional të tij, për mandatin e dytë...

SHBA sanksionon 8 majin, fshikullon bojkotin e Ramës

Thërrmohen shpresat e opozitës për shtyrje të zgjedhjeve vendore dhe nisjen e një negociate politike që do t'ia jepte Edvinit pushtetin në tavolinë. Ambasadori amerikan Arvizu u ka bërë thirrje qytetarëve të përfshihen në organizimin e zgjedhjeve të 8 majit. Me mesazhin se Shqipëria është vend i stabilizuar dhe përpjekja për destabilizimin e zgjedhjeve dhe të institucioneve do të ndëshkohet, vjen në Tiranë edhe zëvendësi i sekretares së Shtetit, Hillari Klinton, Xhejms Shtajnbërg

Zëvendëssekretari amerikan i Shtetit James Steinberg dhe zëvendësi i tij Thomas Countryman do të zhvillojnë një tur 4-ditor në Shqipëri, Bosnjë, Armeni, Gjeorgji dhe Azerbajxhan, duke nisur nga dita e sotme.

Sipas njoftimit në faqen e internetit të Departamentit të Shtetit, qëllimi i vizitës, sipas të

njëjtimit njoftim është forcimi i rëndësisë së zgjedhjeve lokale, si zgjidhje për ngërçin politik.

Një tjetër kërkesë, e cila mendohet të gjejë vend në axhendën e diplomatëve të Uashingtonit, do të jetë pjesëmarrja në zgjedhjet e 8 majit, duke përjashtuar këtu mundësinë për zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme, siç

kërkon opozita.

Në takimet që do të zhvillojnë në Shqipëri, me drejtuesit me të lartë të politikës, diplomatët do të ritheksojnë rëndësinë e zgjedhjeve lokale për zgjidhjen e ngërçit politik si dhe do të përforcojnë rolin e Prokurores së Përgjithshme në hetimin e ngjarjeve të 21 janarit.

Thomas Countryman në vizitën e tij në Tiranë para disa ditësh me synim zgjidhjen e ngërçit politik i bëri thirrje klasës politike për dialog dhe zgjidhjen e situatës. Thomas Countryman dënoi dhunën e demonstruesve opozitarë më 21 janar. Thomas Countryman për herë të dytë në Shqipëri, së bash-

ku edhe me shefin e tij James Steinberg.

Pas vizitës në Shqipëri diplomatët amerikanë do të shkojnë më pas në Bosnjë ku do të takohen me udhëheqës qeveritarë dhe politikë për të theksuar nevojën e ngutshme të krijimit të një qeverie që mund të bëjë përparime në reformat drejt institucioneve euro-atlantike.

SHBA: Zgjedhjet e 8 majit, të rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë

Shtetet e Bashkuara i vlerësojnë zgjedhjet e këtij viti ndër më të rëndësishmet për të ardhmen e vendit.

Nga rezidenca amerikane, ambasadori Aleksandër Arvizu së bashku me diplomatët e Bashkimit Europian dhe të OSBE-së të akredituar në Tiranë, i kanë kërkuar politikanëve një fushatë konkurruese, gjithëpërfshirëse. „Vëzhgimi është pjesa kryesore e ditës së zgjedhjeve dhe ndihmon në sigurimin që ato të jenë të besueshme si dhe në përputhje me frymën dhe germën e ligjit. Këto zgjedhje janë shumë të rëndësishme për Shqipërinë. Ne presim që të shohim konkurrencë dhe fushatë zgjedhore mes shumë partive që përfaqësojnë pikëpamje të ndryshme. Zhvillimi i fushatës është pjesë e procesit demokratik dhe është i nevojshëm. Qytetarët duhet të dëgjojnë ç'ka thonë politikanët dhe çfarë përfaqësojnë në mënyrë që të marrin vendimet e duhura“, tha Arvizu.

Gjatë kohës kur ambasadori njoftonte dhënie të 360 mijë dollarëve për vëzhgimin e zgjedhjeve, në rezidencën amerikane ishin të pranishëm deputetë të PS-së dhe PD-së. Fondi do të shkojë për organizata joqeveritare monitoruese të 8 majit.

„Nëse quheni Sali Berisha keni një votë. Edhe Edi Rama, ka një votë, po ashtu dhe Ina Rama dhe Luan Rama. Apeli im për qytetarët shqiptarë është vota juaj ka vlerë. Po ashtu është e rëndësishme për partitë politike t'i ofrojnë qytetarëve shqiptarë një mundësi zgjedhjeve për zgjedhjet vendore sepse ato janë zgjedhje për të ardhmen e Shqipërisë. kjo është arsyeja pse SHBA kanë vendosur të japin fonde për to“, tha Arvizu.

Diplomati amerikan njoftoi gjithashtu dhe hapjen e një konkursi në „Facebook“ për sloganin më të mirë të këtyre zgjedhjeve, për fituesit e të cilit do të ketë dhe një çmim.

Ndihma e Qeverisë së SHBA për monitorimin e zgjedhjeve të 8 majit/Ambasadori i SHBA Aleksandër Arvizu njoftoi dje se Ambasada e SHBA në Tiranë do t'i kushtojë afro 360,000 dollarë për ndihmës për shoqërinë civile në lidhje me zgjedhjet. Fondet do të përdoren për monitorimin e zgjedhjeve vendore, të planifikuara



për më 8 maj 2011.

Në ceremoninë, ku ishin të pranishëm përfaqësues të shoqërisë civile dhe medias, Ambasadori vuri në dukje rëndësinë e ushtrimit të së drejtës së votës.

„Çështja është që cilido ka një votë dhe vota e secilit ka po aq vlerë sa e kujt do tjetër dhe, që Shqipëria të ecë përpara, është me rëndësi që të ushtroni të drejtën tuaj për të votuar. Është po ashtu me rëndësi për ata... që përfaqësojnë pikëpamje të ndryshme politike që t'iu japin votuesve shqiptarë një mundësi zgjedhjeve që të mund të bëjnë një zgjedhje. Këto zgjedhje kanë të bëjnë me të ardhmen e Shqipërisë“, u shpreh ambasadori Arvizu.

Financimi ofrohet nga Sektori i Marrëdhënieve Publike i Ambasadës dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), të cilat kanë vënë në dispozicion fonde për të ndihmuar një „Koalicion të Vëzhguesve Vendas“.

Koalicioni i organizatave joqeveritare do të monitorojë të gjithë procesin e

zgjedhjeve. Koalicioni do të ofrojë edhe edukim të votuesve.

Duke iu drejtuar koalicionit vendas për vëzhgimin e zgjedhjeve, Ambasadori u shpreh se, „dëshiroj t'ju uroj sukseset më të mira dhe ju kërkoj që detyrën e vëzhguesit të zgjedhjeve ta merrni me seriozitet dhe integritet. Puna juaj do të jetë e shumë rëndësishme për të kontribuar që këto zgjedhje të jenë të suksesshme dhe që ato të përfaqësojnë vullnetin e popullit shqiptar“, deklaroi ambasadori amerikan në Tiranë, Aleksandër Arvizu.

Programi i Granteve të Vogla për Demokracinë, i cili administrohet nga Sektori i Marrëdhënieve Publike i Ambasadës, do të sigurojë afro 160.000 të gjithë fondit. Këto fonde do të mbulojnë koston e monitorimit dhe edukimit të votuesve, si dhe veprimtari të tjera shtesë. USAID do të kontribuojë 200.000 \$ për të ofruar trajnim për vëzhguesit e zgjedhjeve si dhe një këshilltar ndërkombëtar trajnimi për të punuar me grupet vendase.

Kryeparlamentarja i tregon së majtës vetëm një rrugë shpëtimi, zbatimin e kushtetutës
Topalli: "Në një vend demokratik, zgjedhjet s'mund t'i bllokojë askush"

Kryetarja e Kuvendit Jozefina Topalli i është përgjigjur dje interesimit të mediave në lidhje me pretendimet e opozitës për zgjedhjet e 8 majit. Ky prononcim për mediat ka ardhur menjëherë pas aktivitetit të zhvilluar nga kryeparlamentarja Topalli, mbi pjesëmarrjen e grave në politikë.

Kryeparlamentarja Topalli i është kundërpërgjigjur edhe deklaratave të një dite më parë bërë nga kryetari i grupit parlamentar të opozitës Gramoz Ruçi. E pyetur nga mediat, kryetarja e kuvendit, Jozefina Topalli, tha se për sa u përket pretendimeve të opozitës, në lidhje me pjesëmarrjen e saj në zgjedhjet e 8 majit, gjithçka përcaktohet qartë nga kushtetuta. Kryeparlamentarja Topalli theksoi se „Në Shqipëri ka vetëm një zgjidhje dhe kjo është futja brenda shinave kushtetuese të atyre që dështuan me dhunën e tyre për të përmbysur një qeveri legjitime“. Ka vetëm një zgjidhje dhe ajo është Kushtetuta e Shqipërisë. Unë i ftoj të kthehen te Kushtetuta. Është ligji suprem i Shqipërisë dhe i shqiptarëve. Është Kushtetuta e çdo shqiptari“, u shpreh kryetarja e Kuvendit Jozefina Topalli.

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Gramoz Ruçi ka vënë tre kushte për mazhorancën për të hyrë në zgjedhje, ndër to edhe riformatimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Çfarë qëndrimi do të mbajë mazhoranca për sa i përket kësaj pike?

Së pari 8 maji do të jetë një ditë shumë e rëndësishme, në të cilën çdo qytetar do të ketë mundësi të vendosë për atë që do të jetë kryetari i komunës, kryetari i bashkisë, i cili ka impaktin më të madh në jetën e qytetarëve kur menaxhohet me seriozitet, me përgjegjësi dhe me vizion. Unë mendoj se çdo gjë edhe në këto zgjedhje, ashtu si në zgjedhjet e kaluara që ishin zgjedhjet më të mira, përcaktohen në bazë të Kushtetutës. Respekti kushtetues, respekti i ligjeve që i kemi bërë bashkë, i kemi votuar bashkë me mazhorancën më të madhe të mundshme. Nuk ka ndodhur ndonjëherë që të kemi kaluar ligje me një kompromis kaq të gjerë dhe me një votë kaq të rëndësishme.

Por, pa opozitën a mund të ketë zgjedhje?

Unë mendoj se 8 maji do të jetë një shans i madh për çdo qytetar. Siç thonë partnerët tanë ndërkombëtarë: pronarët e zgjedhjeve janë qytetarët dhe askurrkush nuk mund t'i pengojë ato.

Megjithatë, KQZ është e bllokuar, sepse të tre anëtarët e majtë nuk shkojnë...?

Në fakt po punojnë çdo ditë me integritetin dhe vendosmërinë më të madhe në zbatim të ligjit dhe të Kushtetutës. Në Shqipëri ka vetëm një zgjidhje dhe kjo është futja brenda shinave kushtetuese të atyre që bënë 21 janarin, të atyre që dështuan me dhunën e tyre për të përmbysur një qeveri legjitime. Ka vetëm një zgjidhje dhe ajo është Kushtetuta. Unë i ftoj të kthehen te Kushtetuta. Është ligji suprem i Shqipërisë dhe i shqiptarëve. Është Kushtetuta e çdo shqiptari.

Haxhinasto-D'Elia

"Bashkëpunim me OSBE-në"

Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme, Edmond Haxhinasto, priti dje në një takim Ambasadorin e Republikës së Italisë në Republikën e Shqipërisë, Saba D'Elia.

Zyra e shtypit e MPJ-ve, bëri me dije se gjatë

takimit, ministri Haxhinasto vlerësoi marrëdhëniet e ngushta e miqësore të bashkëpunimit dypalësh me Italinë, që sikundër cilësoi ai është partneri ynë strategjik. Haxhinasto vlerësoi mbështetjen që qeveria italiane i jep Shqipërisë

në procesin e integritimit evropian të vendit. Më tej, ministri Edmond Haxhinasto dhe ambasadori Saba D'Elia biseduan për çështje konkrete të bashkëpunimit në kuadër të organizatave ndërkombëtare, veçanërisht të OSBE-së.

Edhe në valë bojkoti, s'ndalet lufta e brendshme e PS-së për thelat e bashkive

Redaksionale

Nëse "qeveria vret shqiptarët me keqshqyerje", për ekuilibër substancial, Erjon Braçe i vret shqiptarët me demagogji infantile. Rikthimi i deputetit të Beratit në konferenca për shtyp të Partisë Socialiste dëshmon sakaq për nisjen e fushatës elektorale nga ana e opozitës së bashkuar. Dhe për sefte PS-ja kishte si një plan "A", po ashtu dhe një plan "B". Plani i parë synonte ta kthente komisionin e Ekonomisë si një qendër propagande duke futur jashtë rendit të ditës thirrjen e Ministrisë të Ekonomisë për një debat në lidhje për rritjen e çmimeve. Sigurisht, me arsye maxhoranca refuzoi. Kurse Partia Socialiste përdori planin "B" të konferencës denoncuese për mediat, ku njeriu i madh e i vogël Erjon Braçe shpalosi

teoremën akuzatore, "një qeveri që vret për të vjedhur, vret për të sunduar nuk ndalet në asgjë...Qeveria është në detyrë për të vjedhur e vvarë për të vjedhur...për rrjedhojë qeveria vret shqiptarët me keqshqyerjen duke rritur çmimet". Natyrisht akuza e PS-së do burgim të përjetshëm të qeverisë Berisha.

Mirëpo qeveria Berisha për koincidencë dje pati në krah të saj fjalën e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani, i cili tha se "ecuria ekonomike është e qëndrueshme dhe se rritja e çmimeve në vendin tonë vjen si rezultat i rritjes së çmimeve në tregjet botërore". Po kështu një tjetër autoritet i ekonomisë si drejtori i Kooperacionit Italian për Zhvillim në Shqipëri, Aldo Sicignano gjatë prezantimit të projektit për mbështetjen e bizneseve

shqiptare në anën teknike deklaroi se tashmë Shqipëria ka ecur para. Këtë e di mirë Partia Socialiste, ndonëse politika e përditshme ushqehet me demagogji dhe përgënjeshtime të realitetit ekonomik.

Sidoqoftë në dallim nga konferencat e mërzitshme të Megit, të Besnikut a Taulantit, trakti politik i lexuar nga Braçe ishte me përmbajtje, edhe pse ideologjike brenda kishte mbrumë të majtë, çka i vlen retorikës së PS-së. Në ndryshim me lahutën e hajnisë, deputeti Braçe përndryshe Halit Berati i Partisë Socialiste kapi realisht temën se ku duhet fokusuar politika, pra tek qytetari i thjeshtë dhe jo tek demonstrata-funebër pa shtyllë kurrizore.

Ndërkohë Halit Berati i PS-së, ka ca probleme me kolegët deputetë të qarkut të Beratit e të Kuçovës, më saktësisht me Fidel Yllin dhe

Ermonela Felajn, të cilët kanë filluar të përzgjedhin kandidatët për Bashki dhe Komuna të Beratit dhe Kuçovës pa pyetur askënd, as Erjonin. Këta kandidatë të Partisë Socialiste do të vlerësohet sipas pasurisë që kanë në bankë ose poshtë dyshekut dhe jo për kontribute në Partinë Socialiste, e cila është kthyer në një parti elektorale ku kandidimin për të drejtuar një bashki a komunë e merr ai që ka lekë më shumë dhe që i hyn në zemër kryetarit. Këtë iter përzgjedhës, kreu i PS-së, Edi Rama e ka bërë fakt me përzgjedhjen krejt personale dhe amoralë të deputetëve të Partisë Socialiste,

Muaji shkurt është afati i fundit që Partia Socialiste i ka vendosur vetes për të përzgjedhur kandidatët për kryetar të njërive vendore, në bashki, njësi bashkiake dhe komuna. Faza e parë e

përzgjedhjes ose thënë ndryshe e kandidatëve për kandidatë, e cila është duke u bërë nga deputetët e qarqeve në bashkëpunim me krerët e partisë në bazë, është një procedurë, sa për sy e faqe, për të dhënë idenë se mikson kështu mendimin e bazës me atë të të zgjedhurve në Parlament. Natyrisht nuk është krejt kështu. Gjithsesi procedura do që deputetët të përcjellin kandidaturat e përzgjedhura në fazën e parë për çdo komunë dhe bashki dhe pasi t'ia bëjnë të ditur PS-së në qendër, do t'i konsultojnë ato me asamblatë rrethive, ku do të diskutohet për kandidaturat e evidentuara deri më tani, por edhe për të përfshirë në këto lista edhe ndonjë kandidaturë tjetër. Në fund është kreu i PS-së do të bëjë përzgjedhjen e tij duke patur parasysh edhe detyrimet që do t'i lindin nga marrëveshja financiare.

Meditim për politikanët që bëhen të pabesueshëm

Nga Kostaq Xoxa

Opozita jonë, nën drejtimin e maniakut për pushtet absolut, E. Ramës, është sui generis, që do të thotë jo me tiparet e një opozite që vërejmë në shtetet e BE-së. Sepse nuk gjendet në të gjithë Bashkimin Europian, madje edhe në demokracitë euro-atlantike, një forcë opozitare që të mos ketë, qoftë edhe një episod të vetëm bashkëpunimi me qeverinë, siç paraqiten marrëdhëniet pozitë-opozitë në vendin tonë. Qeveria jonë, është e miratuar për legjitimitetin e saj, e vlerësuar në zgjedhjet e 28 qershorit 2009 nga monitoruesit e huaj vëzhgues, është e mbikëqyruar nga 20 mijë komisionerë të devotshëm të formacionit politik që mbeti në opozitë, e certifikuar nga KZAZ-të dhe e sanksionuar nga KQZ-ja; ndërsa formacioni opozitar përbëhej nga një pjesë elitare e PS-së, LMN-ja, që e quajti humbës Edi Ramën, por që u shtyp me grusht të hekurit, në mbledhje misterioze të mbyllura, aspak transparente, jashtë pjesëmarrjes së gazetarëve, me shkatërrim të kamerave të këtyre. Së fundi, mori fizionominë e një force politike që u quajti nihiliste nga opinioni i përgjithshëm, për obstrukcionizmin radikal të kreut të opozitës, që e vuri këtë opozitë nën pushtetin e tij absolut.

Kësisoj kryetari i PS-së së sotme është quajtur nga një pjesë e rëndësishme e opinionit publik - të pasqyruar në të përditshmet dhe në medien televizive, për arsyen e zanafillës së ngjizjes së kësaj opozite që zotëron sot në vendin tonë, - si kryetar në detyrë. Është një përsëritje e bezdisshme që të përsërit atë që është thënë, gjer në atë pikë që është bërë zakon të quhet si inflacion opinioni, ajo zanafilla e Edvinit për shpërfilljen e nenit 28 të statusit të PS-së me synimin që ai vetë të mbetet në krye të partisë, në shkelje të këtij statusi. Kjo është pikënisja e keqtrajtit të LMN-së dhe dhuna antidemokratike brenda radhëve, gjë e cila u arrit pa marrë parasysh asnjë nocion demokratik, asnjë kriter transparenca të njëmendtë dhe në kundërshtim flagrant me normat statusore të partisë.

Kështu opozita jonë ose, më saktësisht, opozita e drejtuar nga E. Rama, është bërë harbute në mëtime të palogjikshme, në kërkesa të pamundshme nga pikëpamja ligjore, në një trill arrogancë të shfrenuar në marrëdhënie me gazetarët.

Njëri ndër gazetarët e majtë të medieve tona, me shumë delikatesë i kujtoi, në ndërhyrjet e tij, kryetarit të PS-së se ishte prapa në realizimin e programit. Por i intervistuar vazhdonë në stërzgjatjet e përsëritjet e tij, ndërsa gazetarit shihte orën herë pas here. Në fund e falënderoi të intervistuarin, duke shtuar, si me të qeshur, edhe se kishte mundur ta realizonte vetëm pjesërisht numrin e pyetjeve. Intervistuesi tregoi një finesë kundërvëniesje dhe elegante. Gazetarë të tjerë janë fyer si joprofesionistë, e të tjera, pa u zgjatur më tej, sepse është një gjë e njohur nga audiencia.Tani Edi Rama e ka

shtuar mujshinë e tij gjer në atë shkallë, sa kërkon të diktojë edhe për të ushtruar trysni kundër kryetarit të KQZ-së, Ristanit. Në të vërtetë Ristani është treguar krejt objektiv në ushtrimin e të drejtave të tij, si kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Natyrisht ai kishte për detyrë të vlerësonte në mënyrë të paanshme, si vërejtjet e komisionerëve të PD-së, ashtu edhe ato të komisionerëve të PS-së. Ishin jo pak, por nga 20 mijë komisionerë për secilën palë. E. Rama nuk thotë dot se kryetari i KQZ-së nuk i pa seriozisht dhe me objektivitet shënimet e komisionerëve të PS-së. Por nuk vonoi të nxirrte atë absurditetin e "tradhtisë" së komisionerëve, paçka se ishin të përzgjedhur një për një prej atij vetë. Për më tepër, vendimi nga shqyrtimi i materialeve zgjedhore dhe vëzhgimi i fletëvotimeve, ishte unanim: 7:0. Kësisoj ai nuk gjen dot asnjë vërejtje objektive kundër z. Ristani. Dhe, ajo që nuk ka sesi të gjejë mirëkuptim në zgjedhësin e drejtpeshuar, është pretendimi që ai, Edvini, të ketë dorë edhe në zgjedhjet e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përveç atyre që propozohen nga PS-ja, edhe atyre që janë në tagër të propozimit prej PD-së! Ky konstatim absurd është i ditëve të fundit. Dhe, pasi opozitarët tanë bëjnë sikur janë europianistë dhe atlantikë të përgjëruar, nuk vonojnë të përgënjeshtrojnë vetveten, sapo nuk gjejnë përkrahjen që shpresojnë prej tyre, ndonëse ata janë sjellë me një durim të admirueshëm ndaj kërkesave opozitare të cilat, në mjaft raste, janë të pamundshme, objektivist. Në një gjendje të tillë dëshpëruese arrihet gjer në përfshfaqje të vetvetes, së paku në dy probleme të tyre, që i kanë të trashëguara si një dukuri atavike: Në hipokrizinë se janë perëndimorë autentikë (!) dhe, së dyti, në sindromën e çmendur që të jenë pushetarë dhe të pozicionohen, për pasojë, kundër njohjes së zgjedhjeve, qofshin ato edhe më të mirat e tranzicionit(!). Vetëm për këtë të dytën mund të përmendim bashkëpunimin e panatyrshëm me persona që s'ia kanë dashur ndonjëherë të mirën vendit tonë. Mjafton të përmenden vetëm dy emra: Bash-tinarun dhe Dik Martin. Që të dy me pretendime të habitshme, si aleancë për rikthimin pas të liberalizimit të vizave dhe me absurdin se në shtëpinë antiseptike të Abdulla Katucit mund të bëhen transplant organesh!

Rumuni Boshtinaru është i gatshëm të lobojë për propozimet të vizave ndaj shqiptarëve, kur këta e kanë prituri si ujët e pakët këtë sukses të jashtëzakonshëm të përkushtimit qeveritar shqiptar. T'i bësh keq vendit tënd është një veprimtarë e kobshme, që mund të merrej si ymek vetëm nga verbëria antikom-bëtare e Enverit. Ky përbindësh i interesave kombëtare shqiptare, në emër të internacionalizmit kombëtar, i fundosi në greminë interesat e Kosovës dhe, në vitin 1956, ia ruajti lëkurën Josif Visarionovitci duke dalë kundër destalinizimit, një veprim ky që nuk ka vështruar aspak sesi do të katan-disej vendi ynë, vetëm për hir të interesave pushtetare nga më meskinet. Kjo etje kriminale për push-

tet është përçarur në mënyrë të marrëzishme tek pasardhësi i tij, që ka marrë përsipër ta ngrejë në hosana lavdinë e dikurshme të kultit të individit, në çdo 16 shtator në Pezë. Nuk do të vonojë koha që E. Rama të japë llogari për nëpërkëmbjen e vendimit të AP-së së KE-së, për dënimin e krimeve të diktatorit. Me cilët besidon Edvini për rikthim të vendimit të liberalizimit të vizave? E thamë. Por është e pamundshme; sepse shqiptarët janë sqaruar në mënyrë të qetë, të argumentuar dhe me një gjakftohtësi bindëse nga qeveria jonë e z. Berisha se cilat janë kushtet që të mos biem në sy për keq nga dashamirët tanë euroatlantikë. Ministri i brendshëm, Lulzim Basha ka dalë shumë herë në TV duke i bindur bashkatdhetarët e vet se liberalizimi i vizave ishte i sigurt, në bazë të premtimeve të shumta të personaliteteve të larta të Brukselit dhe të Uashingtonit, të cilët kishin besim në korrektesën e shqiptarëve, të shprehur nga ministri ynë i Brendshëm. Është e vërtetë se serbët nuk kanë ndjekur, në raste të shumta, kriteret e 90-ditëshit në gjastëmujor dhe kushtëzime të tjera që shoqërohen me dhënien e vizave Shengen. Por kjo nuk ka ndodhur me shqiptarët të cilët nuk janë bërë problem, si në rastet që përmendëm. Një intelektual kosovar na tha, në një takim të përbashkët, se i kishte lënë mbresa të forta "durimi shembullor, qartësia e të folurit dhe mënyra e shkathët e arsyetimit të ministrit tuaj të Brendshëm, për të qenë shembullorë në marrëdhëniet me faktorin ndërkombëtar për vizat Shengen, pas të cilave na pret aderimi për kandidaturën në Bashkimin Europian". Ambasadori amerikan, Aleksandër Arvizu, i ka çmuar këto suksese dhe është treguar i çiltër me qëndrimin e durueshëm të policisë dhe të gardës së provokuar nga një e tridh-jeta e pjesëmarrësve në manifestim. Ç'kërkohej? Që gardhi i ruajtjes së institucionit kryeministral, t'u thoshte: urdhëroni? Ata që kanë parë filmimet, e kanë të qartë se cilët ishin provokuesit dhe cili e bënte murin njerëzor që vetëm goditej dhe s'bënte asnjë hap përpara, për më shumë se një orë. Ajo që të habit, është pasiviteti i Prokurorisë së Përgjithshme për të zbardhur të vërtetën dhe infidencen e Presidencës, ndërsa arrestonin atë që kërkonte dëmtshpërbim për makinën e tij të djegur! U akuzua si atentator i E. Ramës(!), por u lirua në gjykatën e Apelit.Kjo është një përsëritje e asaj fabulës së goditjes së xhamave të shtëpisë së tij të atëhershme, që Rama i quajti me ironi "karamela", por që ishte një halucinacion i tij i radhës! Vetëm se donte një makinë antiplumb!

Sa për turmën e 21 janarit me manifestuesit e 20-vjetorit të rënies së shtatës së diktatorit, ato janë të pakrahasueshme për kah numri i pjesëmarrësve. Kjo është dëshpëruese për perspektivën e zgjedhjeve të 8 majit nga ana e opozitës, Prandaj këto zgjedhje trajtohen si një byrek që mund të digjet në furrë, prej E. Ramës. Ndërsa ambasadori Aleksandër Arvizu i konsideroi si nga më të rëndësishmet, në interes të vendit tonë.

Deklarata/Xhon Huard: Autoritarizmi, si shpërfytyrim i pushtetit

Xhon Huard ka qenë kryeministër i Australisë për rreth 12 vjet para se të largohet nga ky post më 2007-ën. Njihet si avokat i fuqishëm i demokracisë dhe sistemit të tregut të lirë. Në intervistën dhënë Radios Evropa e Lirë, zoti Huard, flet për valën demokratike në Lindjen e Mesme dhe mundësitë e Perëndimit për të ndryshuar regjimet autoritare. Ish kryeministri Australian, Xhon Huard, aktualisht avokat i fuqishëm i demokracisë, shpreson se zhvillimet që po ndodhin në Lindjen e Mesme janë vërtetë zhvillime demokratike. "Shpresoj shumë që është vërtetë një valë për ndryshime demokratike. Por, arsyeshem, duhet të pezullojmë çdo gjykim derisa të shohim se si po zhvillohen gjërat, ndonëse unë kam një pikëpamje optimiste". "Një gjë të cilën e cilësoj si shumë trimëruese është fakti se në të gjitha pamjet e protestave, ka pasur pothuajse mungesë totale të çdo lloj anti-amerikanizmi dhe me aq sa unë munda të dalloj, edhe të motiveve anti-zraelite", thotë zoti Huard. "Me sa është parë, turmat përbëhen kryesisht nga të rinjtë dhe këtu mund të ketë shumë mesazhe, jo vetëm për faktin se të rinjtë, natyrisht, shfrytëzojnë mediat e socializmit dhe të komunikimit dhe janë të padurueshëm kur u thuhet se si duhet të sillen, por kjo mundet edhe të nënkuptojë se të rinjtë kanë një qasje më ndryshe ndaj gjërave, që mund të kenë qenë mjetet propagandistike për liderët e tyre", thotë zoti Huard. Duke folur për motivet që nxisin liderët të ndryshëm të regjimeve autoritare të mbajnë pushtetin me çdo kush dhe çdo çmim, ish kryeministri Australian, i cili edhe vetë mund të ketë pasur të bëjë me liderët të këtyre, thotë se varshmëria është një nga arsyet. "Është varshmëria dhe në disa raste shpërfytyrimi i pushtetit. Këtu fjalën e kam për liderët autoritarë që kam takuar dhe më i keq që kam takuar, kur kam qenë lider i opozitës, ka qenë Nikolai Çausheksku; ai ka qenë shembulli më i shëmtuar i një personi autoritar që unë kam takuar", thotë Huard. "Mendjet e diktatorëve, të njerëzve autoritarë, janë shumë të ndryshme. Ata nuk janë të mësuar me kufizime dhe impulsat që përcillen nga këto kufizime dhe në fund, është vetëm çështje niveli kur ata fillojnë të sillen në mënyrën e tyre. Ndonëse disa janë më pak brutalë se të tjerët, ata pavarësisht varen nga aparati brutal i policisë se fshehtë. Të jemi realistë, thotë zoti Huard, çdo regjim diktatorial toleron torturën, krimin dhe çdo formë të shkeljes së të drejtave të njeriut". Por, si të promovohet demokracia? Për shembull, kinezët ishin shumë të zëshëm edhe publikisht kur më thanë se nuk duhet ta takoj Dalai Laman. Unë natyrisht që doja ta takoja kur ai vizitoi Australinë, por a doja apo jo ta takoja, nuk ishte çështja. Kur m'u tha që s'duhej ta takoja, unë u sigurova që të takohesha me të", thotë Huard. "Është me rëndësi të ekspozojmë sistemin tonë dhe të demonstrojmë se kemi procese të sundimit të ligjit dhe i zbatojmë ato sa herë që kemi të bëjmë me regjime autoritare", thotë Xhon Huard, avokat i parimeve demokratike.

Kryeministri Sali Berisha bën thirrje sërish për reformë në drejtësi, si e vetmja mënyrë për të luftuar korrupsionin endemik në pushtetin e qeverisur nga kreu i shtetit

“Të shmangët korrupsioni në emërimet e gjyqtarëve”

Ndryshimet në Kushtetutë për kufizimin e imunitetit të kërkuara nga opozita janë një skenar për të mbuluar dhunimin e shtetit ligjor në 21 janar. Deklarata vjen nga kryeministri Berisha, në mbledhjen e djeshme të qeverisë, i cili pavarësisht kësaj tha se mazhoranca është e gatshme të bëjë ndryshime në kushtetutë për imunitetin.

Gjithsesi për kreun e Këshillit të Ministrave varianti i huazuar nga Bundestagu gjerman për lënien vullnetare të imunitetit, me ndryshimin e procedurës në rregulloren e Kuvendit është një arritje pozitive dhe një shembull që duhet ndjekur edhe nga prokurorët e gjyqtarët. Kryeministri kërkoi nga drejtësia shmangien e praktikave korruptive në emërimet e gjyqtarëve.

Çështja që Kryeministri Berisha sollë në vëmendje të anëtarëve të qeverisë ishin konkluzionet e raportit të Komisionit Europian për ekzistencën e problemeve serioze në procedurat e emërimit, transferimit dhe shkarkimit të gjykatësve dhe prokurorëve.

“Në këtë sistem, tha Kryeministri, siç thuhet në raport, emërimet, shkarkimet, transferimet janë jo transparente e me procedurë shumë të dyshimtë. Raporti i mëparshëm thoshte se të sapoemëruarit marrin ryshfet, për të paguar investimin që kanë bërë”.

Në këtë kontekst, Kryeministri konsideroi të domosdoshme përcaktimin e kriterëve dhe standardeve më transparente në emërimin, transferimin, shkarkimin e gjykatësve dhe prokurorëve. Për përcaktimin e këtyre kriterëve dhe standardeve, Kryeministri i kërkoi ministrit të Drejtësisë angazhimin e përbashkët të ekspertëve shqiptarë me ekipin e Bashkimit Europian që asiston reformën ligjore në vend, të atashuar pranë Ministrisë së Drejtësisë.

“Zoti ministër i Drejtësisë, në raportin e Komisionit Europian ka probleme shumë serioze në procedurat e emërimit, transferimit, shkarkimit të gjykatësve dhe prokurorëve. Është e domosdoshme që ekipi i Bashkimit Europian që asiston reformën ligjore në vend, i atashuar pranë Ministrisë së Drejtësisë, të angazhohet për përcaktimin e kriterëve dhe standardeve më transparente në emërimin, transferimin, shkarkimin e gjykatësve dhe



Pajisja e biznesit me kasat fiskale

Berisha: Do kompensohen në çdo qindarkë

Kryeministri vlerësoi ritmet e pajisjes së bizneseve me kasa fiskale ndërsa ritheksoi se qeveria është e vendosur për kompensimin e tyre në çdo qindarkë të harxhuar për blerjen e kasës. Berisha falënderoi biznesin shqiptar, për shkallën e lartë të përgjegjësisë që kanë treguar në vendosjen e kasave dhe i siguroi se çdo qindarkë do të paguhet nga buxheti i shtetit, si dhe u kërkoi qeveritarëve vendorë të dorëzojnë faturat, në mënyrë që qeveria të disbursojë nga buxheti, në përputhje me premtimin e ligjit që ka kaluar në parlament, çdo qindarkë që kompanitë, sipas ligjit, janë autorizuar ta zbresin në taksat që do paguanin dhe kompensimi do të jetë i plotë nga buxheti qendror.

“Ne kemi vepruar shumë drejtë. Faktikisht, i kemi dhënë ato gratis, por të mos harrojmë se gjeneratori i të gjithë zhvillimit e pasurimit të këtij vendi është biznesi. Pra, u kemi dhënë një ndihmë plotësisht të merituar, sikundër modernizmi, pajisja me kasa është absolutisht identike si edhe pajisja e qytetarëve me pasaporta biometrike, është një shkëputje e madhe dhe ardhje në modernizim. Sistemi kasave është sistemi më modern që ekziston, me server të përbashkët dhe i shërben shumë lirisë së tregut, luftës kundër informalitetit, por edhe shërbimit të qytetarëve. Pas vendosjes së kasave, natyrisht, qytetarët me faturat që do të mbledhin do të kenë të drejtën e rimbursimit. Tani bëhet edhe deklarata e qytetarit për të ardhurat. Kështu, ne po ecim drejt një qëndrimi të ri të shoqërisë shqiptare ndaj taksave, detyrimeve të shtetit ndaj tyre dhe praktikave më moderne”, tha kryeministri Berisha.

prokurorëve. Për deputetët bëme një zgjidhje do ta gjykoja shumë pozitive, e cila është meritë e deputetëve të shumicës që pranuan të vendosin një standard të ri në historinë e parlamentit shqiptar. E theksova në parlament dhe e theksoj sërish në rast se opozita është vërtet e interesuar për kufizimin e imunitetit, të sjellë propozimet për të amenduar Kushtetutën për këtë çështje. Natyrisht, nuk e ka me seriozitet se prapa këtij propozimi fshihen disa propozime të tjera të lidhura me datën 21 janar, para dhe pas saj, të cilat janë të pashpresa, fshihen disa lloj ndryshimesh të tjera në Kushtetutë, të cilat nuk do mund të ndodhin ndonjëherë. Por, në rast se duan të bëhen të sinqertë, ne e mirëpresim. Unë kam ndjekur me interes debatin që u zhvillua dhe që e nxitët ju zoti ministër, për të vendosur një standard të ri nëpërmjet një rregulloreje

të Këshillit të Lartë të Drejtësisë apo Konferencës së Gjyqtarëve për kufizimin e imunitetit. Konstatova se ky propozim u kundërshtua nga drejtuesit e atij institucioni, të cilët kanë edhe përgjegjësinë kryesore për luftën kundër korrupsionit në ato institucione. U propozua si alternativë ndryshimet ligjore që kërkojnë 3/5 në parlament. Faktikisht, të bësh një propozim të tillë, pas bllokimit të ligjit të Gjykatës Administrative, do të thotë thjesht të lash duart me një proces, i cili është i një rëndësie kapitale. E kam theksuar dhe e theksoj se në trupën e gjykatësve dhe prokurorëve ka një tërësi gjyqtarë e prokurorë të përgjegjshëm, që zbatojnë ligjin me ndershmëri e korrektesë dhe i kanë bërë shërbime të mëdha këtij vendi. Në rast se Shqipëria është bërë një vend i sigurt, këta kanë kontributin e tyre thelbësor. Natyrisht,

në këtë sistem, siç thuhet në raport, emërimet, shkarkimet, transferimet janë jo transparente e me procedurë shumë të dyshimtë. Raporti i mëparshëm thoshte se të sapoemëruarit marrin ryshfet, për të paguar investimin që kanë bërë. Në këtë kontekst, është shumë e domosdoshme që të përcaktohen procedurat më transparente, në mënyrë që të emërohen, shkarkohen, transferohen pa lënë nënkuptuar se detyrohen të paguajnë ndonjë gjë e se detyrohen të marrin për të paguar. Ndaj përcaktimi i këtyre kriterëve, sëbashku me Euralius, i cili ka ekspertë të shquar europianë dhe me ekspertë shqiptarë, duhet të jetë një nga përparësitë e punës suaj zoti ministër dhe një nga çështjet kryesore që ju duhet të mbronin në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Unë e di që ju e keni ngritur këtë çështje, por kjo ka shumë muaj dhe çështja duhet të avancojë”, u shpreh kryeministri Berisha. Shmangia e çdo praktike korruptive sipas kryeministrit duhet të ndiqet dhe në një sërë shërbimesh ndaj qytetarëve, dhe mënyra më e mirë sipas tij është dhënies së tyre me koncesion, në shembullin e suksesshëm të kartave dhe pasaportave biometrike.

Një ndër to është kontrolli i naftës në cilësi dhe sasi.

“Lufta kundër informalitetit dhe korrupsionit, tha Kryeministri, janë kushte themelore për lirinë e tregut. Kështu u veprua në shembullin më të shkëlqyer me letërnjoftimet elektronike dhe pasaportat biometrike, të cilat përbëjnë procesin më të përsosur, më të sigurt dhe jashtë çdo praktike korruptive që ne kemi”.

Duke theksuar se në çdo procedurë e proces, kriteri i parë duhet të jetë lufta kundër korrupsionit, Kryeministri Berisha tha se një tjetër aspekt që nuk duhet neglizhuar në përpjekjet kundër korrupsionit janë edhe procedurat administrative për blerjet e vogla, për të cilën Agjencia e Prokurimeve Publike po përgatit katalogun elektronik të blerjeve të vogla. Kryeministri theksoi nevojën e përmirësimit të mjedisit në vend, duke investuar në pastrimin e ajrit dhe të ujit. Qeveria do të vendosë edhe për dhënien me koncesion të shërbimi ambulator nga ministria e Shëndetësisë. Në këtë pikë, kryeministri deklaroi se buxheti i shtetit do të rimbursojë vetëm të siguararit dhe ata që nuk kanë mundësi financiare për t'u siguruar.

Kuvendi miraton sot rregulloren e re dhe kufizimin e imunitetit

Kuvendi pritet të zhvillojë sot një seancë plenare të nxehtë dhe me debate mes dy palëve politike, mazhorancës dhe opozitës. Konferenca e Kryetarëve vendosi kohën e debateve mes mazhorancës dhe opozitës në diskutimet e nesërme në seancën parlamentare. Në Kuvend, sot do të diskutohen dhe votohen një sërë ligjesh mes të cilave edhe nisma për kufizimin e imunitetit të deputetëve, propozuar nga Partia Demokratike.

Gjatë mbledhjes së dy ditëve më parë në komisionin e Ligjeve, deputetët sqaruan se ky ndryshim bën fjalë vetëm për rastin e autorizimit për ndjekjen penale, hetimin e deputetit, por jo për autorizimin për arrestimin e tij. Në këtë rast, votimi në seancë është i pashmangshëm. Ndërkohë, opozita do të kundërshtojë ndryshimin e rregullores së Kuvendit që disiplinon qëndrimin e deputetit në foltores. Dy ditë më parë, opozita braktisi punimet e Komisionit të Ligjeve pasi e kundërshtoi si dhunë ndaj të drejtës së fjalës së pakicës amendamentin e ri të deputetit Eduart Halimi për përjashtimin me 21 ditë të deputetëve që zaptojnë foltores e Kuvendit për më shumë se 2 minuta. Largimi i opozitës u pasua me miratimin nga ana e mazhorancës të të gjitha ndryshimeve në rregulloren e Kuvendit. Një ditë më parë grupi parlamentar socialist do të vijojë të mbajë qëndrim bllokues në seancat parlamentare.

Qëndrimi i të zgjedhurve socialistë është rikonfirmuar në mbledhjen e përjavshme të grupit parlamentar drejtuar nga kryesocialisti Rama. Deputetët socialistë do të vijojnë të bllokojnë foltores e Kuvendit si një aksion ky për të bllokuar punimet e parlamentit në kundërshtim me ndryshimet më të fundit të rregullores.

KQZ nis sot regjistrimin e subjekteve zgjedhore

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nis duke filluar nga dita e sotme, regjistrimin e subjekteve zgjedhore që do të marrin pjesë në zgjedhjet vendore të 8 majit. Mësohet se KQZ do të shqyrtojë projekt-vendimin për regjistrimin e dy subjekteve zgjedhore: Partisë Demokratike dhe Lidhjes Demokratike Shqiptare.

Sipas relacionit shoqëruar të projekt-vendimit, “Partia Demokratike, me kryetar z. Sali Berisha, ka sjellë pranë KQZ-së dokumentacionin përkatës për t'u regjistruar si

subjekt zgjedhor pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zgjedhjet vendore të 8 majit”. Gjithashtu, KQZ pritet të regjistrojë nesër si subjekt zgjedhor dhe Partinë Lidhja Demokratike Shqiptare, me kryetar Nikoll Lesin, e cila ka paraqitur pranë këtij Komisioni kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për të marrë pjesë në garën elektorale të 8 Majit. Sipas kodit zgjedhor, neni 64, çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

Nga Agim Xh. Dëshnica

Pas pyetjesh e kërkimesh të shumta, aty nga viti 1993, buzë lumit Erzen, nën një kodrinë afër Urës së Beshirit, u zbulua një gropë me eshtra njerëzish. Ç'që ajo gropë? Prania e grave të përzishme dhe e burrave të tronditur, tregonte se nuk ishte gjetur një tumë ilire, por një varr i përbashkët, varr makabër i vitit 1951. Nga shenja të ndryshme

ata njohën mbetjet nga trupat e 22 njerëzve të dashur, të pushkatuar në mesnatën e 26 shkurtit 1951, të lidhur tok me tela me gjemba, midis tyre dhe një vajzë. Oh tmerr! Përse i vranë ata?

Nuk do të mjaftonin vrasjet e shumë patriotëve, pa gjyq e me gjyq, që nisën qysh nga nëntori i vitit 1944, kur sadisti Mehmet Shehu, i njohur për epitetet „terror i bardhë“, „terror i kuq“, në vitin 1949 do të shprehej: „Ne duhet ta ashpërojmë luftën kundër armiqve të pushtetit tonë, të vrasim njerëz që të mundemi të përballojmë situatën.“

Viti 1951 qe një kohë, kur shumë qytetarë të zhgënyer shprejonin, se pas prishjes me jugosllavët, do të ndodhnin ndryshime të thella. Ata që kishin radio, dëgjonin më kot Radio Londrën, me sinjalin e njohur „Ju flet Londra!“, apo Ankarën, me „Burasi Ankar!“ Ndërkohë natën nëpër rrugët e taracat e Tiranës, aktivistët e Frontit Demokratik, kërkonin fletushkat e hedhura nga duar të panjohura, ndoshta edhe nga qielli, kurse ditën nëpër trotuarë, civilë të paguar gjumronin kalimtarë të dyshimtë. Në mure u dukën pankarta me fjalën e rreptë „Vigilencë!“ Në Durrës, kur qytetarët ktheheshin në shtëpi, gjenin mbi radio letra me shënimin tronditës: „mos hapni radion në kanalet italiane!“ Në bregdet pushuesit porositeshin të ndërprisnin lojën me domino e të hynin ndër fjetore. Nga ditaret dukej në muzg patrulla e rojeve bregdetare me armë në duar. Banorët e majmur të Bllokut, natën shihnin ëndrra të frikshme me sulme të befasishme nga deti e ajri dhe nga malet. Ndaj zgjoheshin të trembur dhe në mbledhje të fshehta, hartonin lista arrestimesh me emra të diktuara nga krerët kryesorë të partisë, disa të njoftuara edhe nga agjentët e sigurimit.

Befas, në krahun e shkretët të oborrit të Ambasadës Sovjetike në rrugën e Durrësit në Tiranë, shpërtheu një sasi e pakët dinamiti, nga e cila u thyen vetëm disa xhama. Dhe ja, brenda një nate, sipas listave të përgatitura qysh më parë, u shoqëruan të lidhur mbi treqind vetë, midis tyre, Sabiha Kasimati, dijetare e Institutit të Shkencave, Jonuz Kaceli, nga familja e madhe e Kacelëve, Ing. Vasil Noçka, një prej yjeve të Universitetit të Shtutgardit, Prof. Ibrahim Babamusta, personalitet i njohur i kulturës perëndimore, Gaqo Qano, doktor i kirurgjisë dentare, i kthyer nga studimet në SHBA, Gani Strazimiri, inxhinier i shquar i ndërtimit, Rok Radovani, profesor i kimisë, Tefik Gabrani, ekonomist, zotërues i disa gjuhëve, patriot i kthyer nga Selaniku në atdhe për Kosovën e shumë të tjerë. Nga listat e zeza nën diktatën e E. Hoxhës dhe të M. Shehut, u përzgjedhën për pushkatim 22 vetë, të gjithë banues në Tiranë. Shumë njerëz qenë të bindur se atentati dhe arrestimet u kryen me urdhër nga lart, me anën e shërbimit të fshehtë, me emrin Sigurimi i Shtetit, duke fashitur kështu ëndrrat e shpresat e qytetarëve për shembjen e diktaturës. Asnjë nuk u pyet për ngjarjen e bujshme me dinamit, por veç për ndodhi e biografi të paralufës. Madje pati zyrtarë rusë që ndërhyr për lirimin e disa prej tyre. Ishte koha, kur marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, po bënin hapat e para.

Ata 22 fatkeq, pasi lindën, u rritën dhe u shkolluan, ecën nëpër udhën e jetës, herë me gëzim të pakta, herë të tronditur nga zhgënjime, apo nga dramat familjare, së fundi do t'i prishte një mbarim tragjik, nga dora gjakatare e tiranit komunist E.Hoxha dhe e xhelatit

Mesnata e ftohtë e një pushkatimi barbar, 60 vjet më parë

M. Shehu. Pas arrestimit u pushkatuan në mbarim të pesë ditëve, pa prokuror, pa gjyq e pa asnjë shpjegim zyrtar, në mesnatën e 26 shkurtit të vitit 1951, pranë Urës së Beshirit. Ky veprim u quajt i përligjur, sipas një dekreti mizor me gjashtë nene, për „veprimtaritë terroriste“ që u hartua me vonesë nga kreu i Ministrisë së Brendshme M. Shehu dhe u miratua rufeshëm nga Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe Byroja e PPSH, më 26 shkurt 1951, kur gjithçka, pa gjyq, kish marrë fund. Ministri i Drejtësisë u përgjastua nga kjo orgji juridike e pështirë. 26 shkurti shënon një datë të zezë të drejtësisë shqiptare që ngjeth jo vetëm çdo jurist në botë, por edhe njeriun më të thjeshtë. Një oficer i lartë i asaj kohe të mbrapsht dëshmon: „Për pushkatimin e këtyre personave, nuk është bërë gjyq dhe këtë e them pasi nga pyetja që bëhej nga zyrat e Ministrisë së Brendshme, ata janë çuar direkt në vendin e pushkatimit dhe nuk është lënë kohë për gjykimin e çështjes.“ Pra, asnjë seancë gjyqësore nuk u zhvillua. Nuk u dëgjua as prokurori, as gjyqtari. Mungonin dëshmitarët dhe avokati. Viktimat, të lidhur me tela me gjemba të kohës së luftës, i hipën në një kamion. Jonuz Kacelin të vdekur nga torturat e hodhën nga dritarja. Askush prej tyre nuk u njoh me vendimin. Në mes të natës, kur era e maleve ulurinte si mallkim, i pushkatuan barbarisht të gjithë ashtu siç qenë, të lidhur tok. Kur krismat e armëve pushuan, u dëgjua britma e dhimbshme e një gruajë: „Çi i paskam bërë perëndisë!“ Ishte Sabihaja! Plumbi nuk e kishte kapur! Atëhere ushtarët u sulën dhe ia shuan jetën, duke e qëlluar egërsisht me kondaktë e pushkëve. Pas disa çasteve britma pushoi. Ndihej vetëm ulërima e erës dhe rrjedha e tërbuar e Erzenit. Një vetull hëne e pikëlluar rrezëlilinte midis reve. Të vranët, ashtu siç qenë, i mbuluan shkel e shko, në një gropë të përbashkët. Gjithçka kishte marrë fund. U dëgjua një motor që u ndez. Xhelatët, pasi mbaruan detyrën me sukses, u zhdukën si hajna nëpër natë. Në të nesërmen nëpër shtëpitë e Tiranës, fshatarët e fshatit pranë, trokitën të tronditur në dyert e miqve të tyre dhe sipas një zakoni të lashtë, rrëfyon se ç'kishte ndodhur në mes të natës. Më vonë, ndërsa punohej për shpyllëzimin e asaj zone, një traktoristi i ra të fikët, kur pa që traktori nxori papritur një kufomë gruajë dhe po e zvarriste. Qe trupi i patretur i martires Sabiha Kasimati...

Pas ekzekutimit të viktimit, që shkuan drejt vdekjes pa e ditur pse, dokumentet gjyqësore u plotësuan të mangëta. Kur viktimat nuk jetonin më, nga një dokument i vonuar gjyqësor, merret vesh një vandalizëm i paparë, se më datën 27 shkurt 1951, një trup gjyqarësh fantazmë i përbërë nga tre vetë, pa praninë e prokurorit, kish dhënë një vendim: dënimin me vdekje për 22 të vdekur! Në atë dokument të turpshëm mungon sërish një nënshkrim. Pra, blokmenët, uzurpatorët e Shqipërisë, me atë vrasje, kërcënuan drejtësinë, kërcënuan edhe Zotin. Me këtë rast E. Hoxha u rek të tregonte dashurinë e madhe për miqtë e rinj sovjetikë, e mbi të gjitha të qetësonte jetën e tij të mbrapsht. As Shekspiri i tragjedive, s'do të mund të gjente fjalë për të treguar, sesi brenda një nate u krye ajo masakër e llahtarshme.

Pas atij akti kriminal, diktatori E. Hoxha do të hakërrehej me grushin lart: „Reaksioni i brendshëm është struktur si miu dhe po lëviz, e piu e zeza!“

Ja cilët ishin ata, që humbën jetën, shumica në moshë të re, pa asnjë faj, nga pushkatimi mizor në natën e ftohtë të 26 shkurtit 1951: -Sabiha Kasimati, 38 vjeç. E lindur në Eclëme të Turqisë, e diplomuar në Itali. Megjithëse u ofrua një vend pune në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kjo vajzë patriot e ditur, dëshiroi vendin e saj, Shqipërinë. Pas kthimit në atdhe, punoi në Institutin e Shkencave krahas shkencëtarëve të shquar në histori. Si ishte e mundur të dënohej me vdekje dhe të masakrohej një engjëlli si ajo? Fajtor për këtë krim barbar ndaj asaj vajze të rrallë dijetare, ishte vetë dora e përbindëshit ziliqar, E. Hoxha. -Tefik Shehu 39 vjeç, i lindur në Gjakovë. I diplomuar në Zagreb për ekonomi, financë dhe drejtësi. Në vitin 1939 u vendos e punoi në Tiranë. Pas pushtimit të Shqipërisë u kthye në Gjakovë. Aty u arrestua nga serbët, por mundi të shpëtonë me ndihmën e nacionalistëve shqiptarë. Më 1945 u arrestua nga komunistët shqiptarë në Tiranë, por me ndihmën e avokatit Koço Dilo, shpëtoi nga pushkatimi. Më 26 shkurt 1951, askush nuk mundi ta mbronte nga vandalët. -Pjerin Guraziu 45 vjeç i lindur në Shkodër. Doktor i Shkencave Ekonomike, sportist me rezultate të nivelit ndërkombëtar. Pedagog në shkollën tregtare të Vlorës. Drejtor i Doganës së Tiranës më 1938. Pas luftës, shef finance në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Bujqësisë. Anëtar i komisionit për organizimin e garave atletike në Ballkaniadën e vitit 1946. Për këto aftësi meriti pushkatimin. -Jonuz Kaceli 43 vjeç U lind në Tiranë, në familjen e madhe patriotë të Kacelëve, e njohur për shërbime në dobi të atdheut, në ekonomi, kulture, art etj. Më vonë, sipas një dëshmitari, për këto vlera, sadisti i Ministrisë së Brendshme e vrau në tortura dhe e hodhi nga dritarja. Shkuan vite dhe sadisti i „terrorit të kuq“, u dergj në shtrat i vranë. -Anton Delhysa, 47 vjeç. U lind në Prizren, specialist ndërtimi, kreu me përfundime të shkëlqyera Shkollën Teknikë të Fulzit. Njihet si drejtues i punimeve për ndërtimin e Shkollës Amerikane në Golem të Kavajës, të Shkollës Teknikë të Fullcit dhe të Ambasadës Amerikane në Tiranë. Pas luftës, drejtoi punimet për ndërtimin e fabrikës së sheqerit në Maliq, për spitalin në Gjirokastër, për fabrikën e tullave ë Vorë etj. Për punën e tij, u dekorua edhe nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, së fundi edhe me pushkatim... -Haki Kodra-, 30 vjeç. U lind në Dibër të Madhe. Pasi u diplomua për ekonomi në Universitetin e Zagrebit, u kthye në Dibër, ku ngriti një biznes të madh, por u luftua nga serbët, ndaj u largua dhe u vendos më 1940 në Tiranë. Pas luftës punoi në sektorin ekonomik deri në vitin e zi të pushkatimit 1951. -Gafur Jegeni, 41 vjeç. U lind në Dibër. Ishte një nga përfaqësuesit e shquar të Jegenëve të Dibrës. Kreu studimet e larta në Akademinë Ushtarake në Itali. Nga viti 1935 më 1937, komandant i kufirit bregdetar në Shqipëri. Në ditët e prillit 1939 në Vlorë, me gradën kapiten, kreu detyrën si patriot për mbrojtjen e atdheut. U arrestua dhe gjyqi ushtarak e dënoi me vdekje, më pas u internua në Ventotene. U lirua nga anglo-amerikanët më 1943. Pas kësaj u tërhoq nga ushtria deri në shkurt të vitit 1951. Epilogu: Në vend të plotonit ushtarak italian të ekzekutimit, u ndodh përballë skuadrës së ekzekutimit barbar me ushtarë, që mbanin yll të kuq në ballë. -Myftar Jegeni, 36 vjeç. U lind në Dibër. Kreu Akademinë Ushtarake më

1937 në Itali. Me gradën kapiten më 7 prill 1939, luftoi në Durrës për mbrojtjen e atdheut, më pas edhe kundër ushtrisë gjermane. Kundërshtoi masakrat jugosllave, ndaj serbët pasi e arrestuan e dërguan në duart e komunistëve në Shqipëri. Pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, punoi llogaritar në një ndërmarrje ndërtimi në Tiranë, deri në vitin 1951. Nuk mundi të punonte më sepse në mesnatë e priste pushkatimi i pabesë. -Manush Peshkëpia, 39 vjeç, poet patriot, u lind në Vlorë. Analistët e letërsisë e rendisin krahas me Fishtën. Poradecin, Koliqin, Kutelin etj. Ja, si është shprehur shkrimtari i shquar Vedat Kokona: „Shumë nga shokët e mi vdiqën zemërplatur pas dekada vuajtjesh dhe mjerimesh. Një nga këta fatzinj ishe edhe ti, Manush. Askush në këtë sallë dhe jashtë saj nuk të ka njohur si të kam njohur unë, si vëllai, gjashtëdhjetë vjet më parë...Shumë njerëz kam njohur në jetën time, pak kam çmuar, shumë pak kam dashur siç të kam dashur ty. Ti shkruaje vjersha pa e hequr veten poet, të mos jeshë poet në vargje, nuk është faj. Faj është të mos jeshë njeri. Ti, Manush, ishe poet njeri“. Edhe pas pushkatimit nga terrori i kuq në mesnatën e 26 shkurtit, ky poet njeri mbeti i gjallë në vargje e në dritë. -Reiz Selfo, u lind në Gjirokastër. U shqua si një nga sipërmarrësit e aftë në tregëti dhe në ndërtim. Disa nga veprat, si Firma „Selfo“ në Vlorë, Ura e famshme e Dragotit mbi lumin Vjosë, Ura e Bëncës në Tepelenë, disa shkolla, ndër to, Gjinnazi në Gjirokastër dhe shumë të tjera, janë tregues të qartë të ndihmesës së tij për lulëzimin e Shqipërisë, por dora e diktatorit E.Hoxha, më 26 shkurt 1951, ia rëmbeu pa mëshirë, jetën këtij biznesmeni të madh patriot. -Qemal Kasaruho, 49 vjeç. U lind në Gjirokastër. Ekonomist, zotërues i disa gjuhëve të huaja, në vitet 20-40 punoi si kryeinspektor në doganën e Sarandës, më pas drejtor i përgjithshëm i Monopoleve dhe i Tatimeve në Ministrinë e Financave, ndër kohë mori pjesë në luftën kundër pushteveve italo-gjermane. Pas luftës nuk u pranua të punonte si ekonomist në Tiranë, por jashtë saj, në minierën e Rubikut, së fundi jashtë nga jeta, por nuk mundën ta fshinin nga kujtesa e Kombit. -Zyhd Herra, 30 vjeç. U lind në Tiranë. Studjoi në Liceun e Korçës dhe në Gjinnazin e Tiranës, më pas vazhdoi studimet për drejtësi. Gjatë luftës bashkëpunoi me Frontin N.Ç. Pas luftës kryeredaktor i gazetës Bashkimi në Tiranë. Më pas e priste pushkatimi pa gjyq, e pa faj. -Gjon Temali, 47 vjeç. U lind në Shkodër. Në vitet 40 studioi për farmaci në Universitetin e Firences. Nga viti 1946 deri në shkurt të vitit 1951, farmacist në Spitalin e Tiranës. Ky njeri, i përkushtuar në shërbimin human të mjeksisë, duhej të vritej si „terrorist“, pa gjyq e pa faj. -Petro Konomi, 30 vjeç. U lind në Kajro. Kreu studimet e larta në Turqi në Robert Kolezh, mandej në Akademinë Ushtarake në Itali. Gjatë luftës përkrahu Frontin N.Ç. Pas luftës u emërua në ATSH. Edhe ky punonjës engjëlli, duhej lidhur me tela, për t'u vranë. -Niko Lezo, 50 vjeç. U lind në Delvinë. Kimist. Zotërues i disa gjuhëve të huaja. Ka kryer Universitetin e Tuluzës. në vitin 1921. Më 1923, ngriti të parin laborator kimik në Tiranë. Po atë vit zgjidhet deputet i Delvinës. Më 1940 arrestohet e internohet në Ventotene. Pas luftës punon sërish kimist në laboratorin, tashmë nën vartësinë e Ministrisë së Shëndetësisë. Ky themelues i paharruar i laboratorit të parë shqiptar, duhej

pushkatuar pa mëshirë. -Pandeli Nova 59 vjeç. U lind në Opar, në një familje të pasur. Ekonomist. Zotërues i disa gjuhëve të huaja. Deri në vitin 1944 u mor me tregëti dhe njëkohësisht ndihmoi Frontin N.Ç. Pas luftës punoi në një shoqëri tregtare çeko-shqiptare. Ky princ, i një djali partizan në mesnatën e 26 shkurtit 1951, do të dëgjonte për herë fundit, zërin e ashpër të komandantit partizan: Zjarr! -Thoma Katundi- Më i „vjetri“ në moshë, 64 vjeç! U lind në Katund të Korçës. Ish-vatran në SHBA. I djegur nga malli, u kthye në atdhe dhe punoi me ndershmiëri. I edukuar nga idetë demokratike amerikane, duke përbuzur çdo tirani, humbi jetën më 26 shkurt 1951. Faj i tij nuk ishte vetëm dashuria për lirinë, por edhe malli për atdheun. -Mehmet Shkupi, 58 vjeç. U lind në Shkup dhe banoi në Tiranë. Ish pronar me arsim të mesëm dhe me profesion nëpunës kaloriferi. Dyshohej si „agjent“ i Legatës Franceze dhe se zhvillonte veprimtaritë terroriste. Pra prova konkrete për dënimin me vdekje pa gjyq, shërbeu sajësa me emrin dyshim. -Ali Qorralliu, 61 vjeç U lind në Tiranë. Tiranasi i pasur. Jurist. Kreu studimet e larta në Kolejin Juridik të Selanikut. Në kohën e luftës ka përkrahu Ballin Komunist, u bashkua në burgos nga regjimi komunist. Megjithatë pas lirimit nuk ndërmori asnjë veprim kundër regjimit. Pa patur asnjë trashëgimtar, u arrestua si „terrorist“ dhe u pushkatua pa mëshirë, pa gjyq. La vetëm kujtimin e një njeriu, të ditur e të pasur. Kur u zbulua varri, u vu re se para pushkatimit ia kishin shkullur dhëmbët e florinjë. -Fadil Dizdari, Me origjinë nga Shkodra, u lind në Kavajë, Në kohën e Zogut kishte punuar si sekretar prefekturë. I dashuruar pas librave dhe të fejuarës së vet, mbante hapur një librarri në qendër të Tiranës. U arrestua dhe u pushkatua pa gjyq, i dyshuar si „terrorist“, apo „armik i Pushtetit Popullor.“ Në të vërtetë faj i tij, ishte bujaria, teksa shiste pothuaj falas kryeveprat botërore, të ashtuquajtura „të verdhna“, të autorëve me famë, si Viktor Hygo, Aleksandër Dyma, Frederik Shiler etj. Shpëtoi vetëm unaza e fejesës që u gjet në gropë, për të dëshmuar për krimin e fshehtë e barbar në mes të natës. -Hekuran Troka, 32 vjeç. U lind në Kuçovë dhe banoi në Tiranë, me profesion tregtar. Në listën e zezë për këtë djalë të hijshëm, është shënuar „tregtar i dyshimtë spekulant“, „agjent i shërbimeve të huaja“ dhe „terrorist“. U pushkatua i dyshuar, pa gjyq. Familja u internua e punoi në punë të rënda për bukë e gojës. Ja, si dëshoheshin me mungesë provash e vriteshin natën ata, që dyshoheshin. -Luka Rashkoviç, 51 vjeç. U lind në Mal të Zi. Ka ardhur në Shqipëri me familjen në kohën e mbretërisë. Gjatë kohëve të ndryshme u mor me transport udhëtarësh, në Shqipëri e Ballkan, jashtë çdo myme politike. Për gjithë këtë jetë të pastër dhe punë të ndershme në shërbim të vendit tonë, u arrestua dhe u pushkatua pa gjyq. Për gropën e braktisur në errësirën e ftohtë 60 vjet më parë, nga xhelatët e nga fajtorët e shekullit, folën eshtrat, folën edhe gurët, folën arkivat e zbuluara edhe ato si supra e të vranëve, foli dhe kujtesa e njerëzve të ndershëm, e motrave, e vëllazërve, e nipave, e qytetarëve dhe e fshatarëve të ndershëm. Folën me zë të lartë që ta dëgjonte bota dhe rinia të merre vesh, megjithëse me vonesë, se kush ishte në të vërtetë Republika Popullore Socialiste, apo Komuniste e E. Hoxhës dhe e M. Shehut, „fanar ndriçues“, burg apo varr i përbashkët i shqiptarëve?

Nga Stanley A. McChrystal
(Foreign Policy)

Ju tregoj përvojën time në fushëbetejën e Afganistanit

Nga fillimi i komandës time në Afganistan, dy ose tre herë në javë, i shoqëruar nga pak ndihmës dhe shpesh nga homologët e mi afganë, unë do të lë selinë e Forcës së Ndihmës të Sigurisë Ndërkombëtare në Kabul e do të udhëtoj përmes Afganistanit – nga qytetet kritike si Kandahari deri tek vendet më të largëta në rajonet kufitare të dhunshme. Ne do nisemi herët, duke bërë udhëtime të vogla e të lehta, normalisht duke përdorur një kombinim të helikopterëve e aeroplanëve të caktuar, për t'u takuar me afganët e udhëheqësit e tyre dhe për t'u lidhur me trupat tona në terren. Brit-sat dhe marinsat e lëkundin përsëri amikun në Helmand, trupat e Ushtrisë Kombëtare Afgane trajnohen në Mazar-e-Sharif, Legjionarët e Patrullimit të Jashtëm Francez patrollojnë në Kapisa.

Unë nuk isha i vetëm: Kishte luftëtarë të tjerë në fushën e betejës. Duke pasqyruar lëvizjet tona, duke konkurruar me ne, ishin udhëheqësit e kryengritjes. Të lidhur me udhëheqësit e Talibanëve dhe shpesh të dërguar prej tyre në Pakistan, u vendosën në të njëjtat zona të Afganistanit. Ata treguan mbështetje publike për guvernatorët e talibanëve, motivuar rangjet e ulëta, rekrutuan trupa të reja, shpërndanë fonde, rishikuan taktikat dhe freskuan strategjinë. Kur qielli i mbush me aeroplanët tanë, udhëheqësit e tyre përdorën telefonat celularë dhe internetin për të nxjerrë urdhra dhe për të mbledhur luftëtarët e tyre. Qëllimi i tyre është të mbajnë të motivuara qelizat rebelë dhe vazhdimisht të informuara, të gjitha pa një komandë të ashpër e të planifikuar.

Ndërsa një kryengritje e thellë me të meta imponohet në ndonjë mënyrë, talibanët janë një kërcënim i shekullit të XXI-të. Duke shijuar avantazhin e kryengritjes tradicionale të jetesës midis një popullsie të lidhur ngushtë me historinë e kulturën, ata gjithashtu përdorin teknologji të sofistikuar që lidh menjëherë luginat e lagështa dhe malet e ashpra – dhe i lejon ato që të shfaqin mesazhin e tyre në mbarë botën, pa u penguar nga koha dhe filtrat. Ata të dy janë të ngulitur thellë në shoqërinë komplekse të Afganistanit dhe janë shumë të shkathët. Ashtu si aleatët e tyre në al-Kaeda, ky taliban i ri është më shumë një rrjet sesa një ushtri, më shumë një komunitet interesi sesa një strukturë korporate.

Për ushtrinë amerikane, që unë kam kaluar jetën time në të, ky nuk është një depërtim i lehtë. Ishte vetëm gjatë rrjedhës së viteve dhe me frustrime të konsiderueshme, që kemi arritur të kuptojmë sesi rrjetet e reja të kryengritësve islamikë dhe terroristëve janë krejtësisht të ndryshme nga çdo armik që Shtetet e Bashkuara kanë njohur ose janë ballafaquar më parë.

Në luftimet e hidhura dhe të përgjakshme në Afganistan e Irak, u bë e qartë për mua e shumë të tjerë që për të mposhtur një armik të rrjetit, ne, duhet të bëhemi vetë një rrjet. Na u desh të gjejmë një mënyrë për të ruajtur aftësitë tona tradicionale të profesionalizmit, teknologjisë dhe kur është e nevojshme, një force të madhe, ndërsa arrihen nivelet e njohurisë, shpejtësisë, saktësisë dhe unitetit e përpjekjes që vetëm një rrjet mund të ofrojë. Ne duhet të orkestrojmë një fushatë të nuancuar popullsi-centrike, që përfshin aftësinë e një goditjeje shkatërruese kundër një force të infiltruar kryengritëse ose vepron në mënyrë të shkathët për të kapur ose vrarë një udhëheqës armik.

Kur shkova për herë të parë në Irak, në tetor 2003, për të komandua një operacion të posaçëm të SHBA Task Force (JSOTF) që ishte përshtatur për shkak të madhësisë relativisht të vogël në muajt pas pushtimit të parë, ne gjetëm një kërcënim në rritje nga burime të shumta – por veçanërisht nga al-Kaeda në Irak (AQI). Ne filluam të

rishikojmë armikun tonë dhe veten.

Asnjë nuk ishte i lehtë për t'u kuptuar.

Ashtu si shumë forca ushtarake të historisë, në fillim ne e pamë armikun tonë siç shikojmë edhe veten. Në një bazë të vogël jashtë Bagdadit, ne filluam të skicojmë AQI në një tabelë të bardhë të thatë që fshihet. E përbërë kryesisht prej muhaxhidinëve të huaj dhe me një besnikëri të përgjithshme ndaj Osama bin Laden-it, por të kontrolluar brenda Irakut nga ana e jordanezit Ebu Musab-Zarkau i, AQI ishte përgjegjëse për një fushatë tejet të dhunshme të sulmeve ndaj forcave të koalicionit, qeverisë së Irak-ut dhe shiitëve iranianë. Qëllimi ishte shpallja e Irakut të ri dhe të krijohet përfundimisht një kalifat islamik. Sipas zakonisht, ne kemi filluar të ndajmë organizatën në një strukturë tradicionale ushtarake, me nivele dhe reshtha. Në krye ishte Zarkavi, poshtë tij një ujëvarë lejantësh dhe ushtarësh këmbësorë.

Sa më afër që ne shikojmë, aq më shumë ky model nuk shkon. Lejtantët e al-Kaedës në Irak nuk presin memorandume nga eprorët e tyre, aq më pak urdhra nga Bin Laden-i. Vendimet nuk ishin të centralizuara, por u morën shpejt dhe u komunikuan në të gjithë organizatën. Luftëtarët Zarkavi u përshtatën në zonat e përhumbura, si Falluxha dhe Qaimi në krahinën perëndimore Anbar të Irak-ut dhe akoma në sajë të teknologjisë moderne janë të lidhura ngushtë me pjesën tjetër të krahinës dhe të vendit. Paratë, propaganda dhe informacioni që rrodhën me ritme alarmuese, lejuan koordinimin e fuqishëm dhe të shkathët. Ne do të shohim taktikat e ndryshimit të tyre (për shembull, nga sulmet e raketave e deri tek shpërthimet vetëvrasëse), gati në të njëjtën kohë në qytete të ndryshme. Kjo ishte një koreografi vdekjeprurëse që arritet me një ndryshim konstant, shpesh të panjohur.

Me kalimin e kohës, ajo u bë gjithnjë e më e qartë – shpesh nga komunikimet e zbuluara ose nga llogaritë e kryengritësve që kishim kapur – se armiku jonë ishte një plejadë e luftëtarëve të organizuar jo sipas radhës, por në bazë të marrëdhënieve dhe njohurive, reputacionit dhe famës. Kush u kalb në burgjet e Egjiptit? Kush u stërvit së bashku në kampet -9/11 në Afganistan? Kush u martua me motrat e tyre? Kush po bën emër për veten e tij dhe kështu po lustron llojin e al-Kaedës?

E gjithë kjo lejohet për fleksibilitetin dhe një aftësi mbresëlënëse për t'u rritur e për të mbështetur humbjet. Armiku nuk do të mbledhë borde promovimi, rrjeti është vetë-formuar. Ne do të shikojmë një Irak të ri që rritet me shpejtësi. Pas arritjes së ndonjë suksesi taktik, ai do të tregtojë vetveten, do të bëjë lidhje, do të gjejë pasues dhe papritmas do të krijohet dhe do të absorbohet një njeje e re e rrjetit. Energjia e rrjetit po rritet.

Në luftë, ju merrni vendime në bazë të treguesve. Kur përballeni me armikun, ju vlerësoni forcën e tij taktike dhe parashikoni strategjinë që ai ka planifikuar. Kjo është shumë më e thjeshtë kur armiku është një kolonë që po avancoon drejt jush nga një pikëpamje më e thjeshtë. Problemi ynë si ai i Iraku-t i vitit 2003, ashtu edhe ai i Afganistani-t i ditëve të sotme është se treguesit po shfaqen kudo, të pabarabartë dhe papritmas dhe shpesh zhduken më shpejt seç shfaqen, duke u dridhur në pamje vetëm për një moment.

Ne kuptuam se kishim aftësinë për të zbuluar ndryshimet në nuanca, nëse lindja e personaliteteve ose aleancave të reja ndryshon papritur taktikë. Gjithashtu,

ne duhet të shqyrtojmë informacionin e ri në kohë reale – në mënyrë që të veprimë në të. Një lumë thëngjish të nxehtë po rridhte kudo rreth nesh dhe ne duhet t'i shihnim ato, të kapnim ato që mundnim dhe të reagonim menjëherë për ato që kishim humbur dhe që kishin filluar t'i venin flakën tokës.

Menjëherë pas marrjes së komandës të JSOTF, kam vizituar një nga ekipet tona në Mosul, qyteti më i madh në Irak-un e Veriut, e cila ishte atëherë nën komandën e Maj. Gen. David Petraeus dhe trupat e divizionit 101 Ajror; edhe pse në Mosul kishte më pak dhunë se në vendet e tjera, ishte e qartë se al-Kaeda po organizohej për të marrë në mënyrë agresive kontrollin e qytetit – dhe, prej andej, të gjithë veriun e Irak-ut.

Forcat tona speciale operative atje, ishin të vogla: rreth 15 burra, të mbështetura nga një analist i vetëm i inteligjencës. Ato ishin vendosur në qoshen e një baze të madhe, që vepronin në heshje nga një rimorkio modeste e bardhë; dhe pse ato koordinojnë me forcat ushtarake dhe civile (sidomos me inteligjencën), agjencive në bazë, procedurat operative të sigurisë dhe zakoneve kulturore të kufizuar sinergjinë e vërtetë të përpjekjeve të tyre kundër al-Kaedës dhe luftën për qytetin që shtrihet jashtë portave të bazës.

Për më tepër, disa antena që stolisin çatinë e rimorkios nuk ishin në gjendje të merrnin shuam informacion të klasifikuar ndërmjet tyre dhe forcave tona të shtabit të përgjithshëm (ose ekupeve të tjera në Irak) me ndonjë afat kohor. Kjo nuk ishte një kuti postare e përparuar, falë ekipit të shquar që drejtojnë këtë përpjekje, por ajo ndjehet si një e tillë.

Atë natë, në aeroplanin për në Bagdad, unë vizatova një orë me rërë në një bllok të verdhë. Gjysma e parë e kësaj ore prej rëre përfaqësonte ekipin në Mosul, tjetra përfaqësonte forcën tonë HQ. Ato u takuan vetëm në një pikë. Në krye, skuadra jonë në Mosul, po akumulonte njohuri dhe përvojë, por i mungonte inteligjenca njerëzore për të transmetuar, të marrë, apo të tresë mjaftueshëm informacion ose që në mënyrë efektive të informuar, të përfitojnë nga selia e task forcës. Kudo nëpër vend – në Tikrit, Ramadi, Falluxha, Diyala – ne po bënim fushata të ngjashme të fragmentuara. Ajo e bëri luftën tonë të vështirë dhe potencialisht të dënuar.

Skema e asaj mbrëmjeje – fillimi i një lufte kundër një armiku që do të rritet më kompleks, i aftë dhe vicioz – ishte hapi i parë në atë që u bë një nga misionet qendrore në përpjekjet tona: ndërtimi i rrjetit. Ajo që ishte e mjegullt, shpejt u bë formula jonë magjike: Duhet një rrjet për të mundur një rrjet.

Modelimi i vetes tonë për t'u kundërvënë rrjetit të amikut, ishte më i lehtë për t'u thënë sesa për t'u bërë, sidomos për shkak se duhet kohë për të mësuar se çfarë, saktësisht, e bën një rrjet të ndryshëm. Siç kemi studiuar, eksperimentuar dhe përshtatur, ishte e qartë se një rrjet efektiv përfshin shumë më tepër se vetëm transmetimin e të dhënave. Një rrjet i vërtetë fillon me lidhjen e fuqishme të komunikimit, por gjithashtu thekson afërsinë fizike dhe kulturore, qëllimin, përforcën proceset e vendimmarrjes, marrëdhëniet personale dhe besimin. Në fund të fundit, një rrjet përcaktohet nga ajo sesa mirë u jep mundësinë anëtarëve të tij për të parë, vendosur dhe të veprimë në mënyrë efektive. Transformimi i një kulture tradicionale ushtarake, në një rrjet të vërtetë, fleksibël dhe të fuqizuar,

është një proces i vështirë.

Përpjekja jonë e parë në një rrjet ishte për të krijuar fizikisht një të tillë. Ne bindëm agjencitë partnere me JSOTF-në, të bashkohen me ne në një tendë të madhe në një nga bazat tona, në mënyrë që ne të mund të ndajmë dhe procesojmë në një vend. Operatorë dhe analistë nga njësi dhe agjenci të shumta, u ulën krah për krah, ndërsa ne shpërndanim përpjekjet e inteligjencës, operacionet dhe kulturën tonë – në një përpjekje të unifikuar. Kjo mund të duket qartë, por në atë kohë nuk ishte kështu. Shumë shpesh, inteligjenca do të udhëtojë deri në zinxhirin e silosë organizative – dhe do të kthehet shumë ngadalë për ata në luftën e marrjes së masave kritike.

Megjithatë, ishte e qartë, se në këtë proces bashkimi ne kishim krijuar vetëm një rrjet të pjesëshëm. Çdo agjenci ose operacion kishte një përfaqësues në tendë, por kjo nuk ishte e mjaftueshme. Rrjeti duhej të zgjerohet, që të përfshinte të gjithë ata që ishin të rëndësishëm për hapësirën e betejës. Rrjeti jo të plotë ose pa lidhje mund të na japin ne idenë e efektivitetit, por janë si mekanizma të hartuar me imtësi, lëvizjet e të cilëve nuk përkojnë me mekanizmat e tjerë.

Ky depërtim na lejon ne që të jemi më pranë ndërtimit të një rrjeti të vërtetë, duke bashkuar të gjithë ata që kanë një rol – pavarësisht sesa të vogël, gjeografikisht të shpërndarë ose sesa i ndryshëm mund të jetë nga ana organizative – në një operacion kundër terrorizmit të suksesshëm. Në e quajtmë atë në stenografisë tonë, F3EA, të gjesh, të rregullosh, të përfundosh, të shfrytëzosh dhe të analizosh. Ideja ishte që të kombinohet analistë që të jenë në gjendje të gjejnë amikun (me anë të shërbimit të fshehtë, të mbikëqyrjes dhe zbulimit), operatorë aeroplanësh që fiksojnë objektivin, ekupe luftuese që e kapin objektivin ose e vrasin atë, specialistë që shfrytëzojnë inteligjencën, të tillë si telefonat celularë, harta dhe të arrestuar dhe analistët e shërbimit që e kthejnë këtë informacion të papërpunuar në njohuri të përdorshme. Duke vepruar kështu, ne përshpejtojmë operacionet kundër terrorizmit, duke mbledhur fakte të vlefshme për disa orë e jo ditë.

Na u desh pak kohë për të arritur deri këtu. Ky proces ka filluar si një zinxhir linear, relativisht jo efikas. Nga zakoni (dhe injoranca), çdo element i dha grupit tjetër shuma minimale të informacionit të nevojshëm që i duhet për të përfunduar detyrën e tij. Duke mos pasur një qëllim të përbashkët ose të mjaftueshëm ose një ndërgjegjësimit të situatës, çdo komponent ka kontribuar shumë më pak tek rezultati sesa ajo që duhet të bënte.

Kjo na shkaktoi ne në retrospektivë, një dhimbje të ngadaltë dhe jo të informuar. Procesi linear krijoi atë që ne e quajmë „injomir“ – vonesat në kohë dhe humbjet e vendeve të bashkimit, ku informacioni ka humbur ose është ngadalësuar. Në ditët e para të përpjekjes, ne kemi pasur eksperiencë të shumta, ku informacioni që kemi mbledhur nuk mund të shfrytëzohet, analizohet apo të reagojë mjaft shpejt – duke i dhënë kohë objektivave armike të shpëtojnë. Një injomir shpesh do të thotë një mundësi e humbur në një luftë të pafalshme.

Çelësi ishte reduktimi i këtyre injomirëve dhe ne e bëmë këtë, duke

u përpjekur për të krijuar një vetëdije të përbashkët ndërmjet çdo niveli të ekupeve kundër terrorizmit. Ne filluam nga shkëmbimi i informacionit: Video të transmetuara nga aeroplanë ju dërguan të gjithë pjesëmarrësve – jo vetëm analistëve dhe mbikëqyrësve që i kontrollojnë ato. Kur një operacion ishte vënë në lëvizje, ai i komuni-kohej vazhdimisht ekipit luftues, në mënyrë që specialistët e zbulimit kilometra larg, mund të njoftojnë ekipin në terren për atë që ata presin të gjejnë në vendngjarje dhe ku ajo mund të jetë. Zbulimi i përmirësuar në vend u zhvendos në mënyrë digjitale nga objektivi tek analistët, të cilët mund ta përkthejnë atë si e dhënë vepruese, ndërsa operatorët do të jenë ende duke pastruar dhomat e duke zbrapsur zjarret. Kjo njohuri u rrotullua përmes lakut të inteligjencës sonë dhe forcave të mbikëqyrjes që ndjekin rezultatet e sulmeve në kohë reale.

Zbulimi përmirësohet në një objektiv, Mosul, mund të lejojë që një tjetër objektiv të zbulohet, të caktohet dhe të përfundojë në Bagdad ose madje edhe në Afganistan. Ndonjëherë, gjetja e një objektivi fillestar mund të çojë në rezultate shumë të mira: Rrjeti ndonjëherë e përfundon këtë cikël tre herë vetëm në një natë të vetme, në vende qindra kilometra larg – të gjitha si rezultat i operacionit të parë. Ndërsa operacioni jonë në Afganistan dhe Irak intensifikohet, numri i operacioneve të kryera çdo ditë rritet dhjetë herë dhe gjithashtu, shkalla e suksesit dhe saktësisë sonë rritet në mënyrë dramatike.

Megjithëse ne e kemi marrë mesazhin tonë, ndryshe nga sa bënë armiqtë tanë, të dyja organizatat ndajnë gjithnjë e më shumë attribute themelore që përcaktojnë një rrjet efektiv. Kufijtë tradicionalë institucionale ranë dhe kulturat e ndryshme u ndërthurën. Rrjeti u zgjerua për të përfshirë më shumë grupe, duke përfshirë dhe aktorët origjinalë. Ai vlerëson kompetencën mbi çdo gjë tjetër – duke përfshirë dhe gradat. Ai kërkon një përcaktim të qartë të problemit dhe të vetë analizuar, duke rishikuar strukturën e tij, qëllimet dhe proceset, po aq mirë sa ato të amikut. Më e rëndësishme është se rrjeti vazhdimisht e rrit kapacitetin e vetë informimit.

Që prej lindjes në Irak, të dy rrjetet aktuale – dhe vlerësimi i fituar me vështirësi për këtë model organizativ – u zgjerua gjithnjë e më shumë në Afganistan, sidomos ndërsa kombet tona e kthenin fokusimin e tyre drejt atij teatri. Kur unë u bëra komandant atje, ne vendosëm për ndërtimin e një arkitekture të fuqishme komunikimi dhe punuar për të vendosur marrëdhënie me aktorët kryesorë, duke lëvizur shpesh në të gjithë vendin për të rrënjësuar vetëdijen e përbashkët dhe qëllimin e domosdoshëm për një ushtri moderne në rrjet. Kjo ishte vetëm pjesa e parë e detyrës. Ndërsa ne mësonim si të ndërtonim një rrjet efektiv, ne gjithashtu mësuam se drejtimi i atij rrjeti – një koleksion i shumëllojshëm i organizatave, personaliteteve dhe kulturave – është një sfidë e frikshme në vetvete. Kjo luftë mbetet një rëndësi jetike, një histori e pa treguar e konfliktit global që është ende në proces e sipër.

***Autori është Ish-Komandanti amerikan i forcave të NATO-s në Afganistan**

Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

"KRIJIMI I GREQISË MODERNE"



D. A. ZAKYTHINOS
**KRIJIMI I
 GREQISË
 MODERNE**

Nga Bizanti te pavarësia

Intelligenda

55
 Shtëpia
 Botuese

Shtëpia Botuese "55" ka hedhur në treg librin "Krijimi i Greqisë Moderne" shkruar nga historiani dhe studiuesi grek D.A. Zakythinos, publikim që vjen nën përkthimin e Virgjil Muçit. Botimi, pjesë e kolanës "Intelligenda", është një vështrim shkencor mbi ngjizjen e shtetit të ri të Greqisë, jo vetëm si shkëputje nga pushtimi osman, por edhe si zanafillë i tezës me pasoja rajonale të Megalidesë

Botimet e reja

Kryeministri, Sali Berisha, uron Behxhet Pacollin dhe Hashim Thaçin për detyrën e tyre

Kryeministri Sali Berisha i ka dërguar dje një mesazh urimi presidentit të ri të Kosovës Behxhet Pacolli, me rastin e zgjedhjes së tij në këtë detyrë. Në këtë telegram urimi kryeministri Berisha shprehet se marrëdhëniet mes dy vendeve do të jenë të shkëlqyera dhe se bashkëpunimi duhet të rritet. „Zgjedhja Juaj në pozicionin e Presidentit të Kosovës më jep kënaqësinë e veçantë, që, në emrin tim dhe të qeverisë shqiptare, t'ju përcjell përshëndetjet më të përzemërta dhe urimet më të ngrohta e miqësore për sukses në misionin e lartë e të rëndësishëm përpara“, thuhet në mesazhin e kreu të qeverisë.

Berisha shpreh dhe vlerësimin për kontributin që do të sjellë për Kosovën zgjedhja e Pacollit. „Republika e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës kanë korrur ar-

ritje të mëdha historike gjatë kësaj periudhe dhe unë ruaj besimin se, si President i shtetit më të ri të Europës. Ju do të sillni një kontribut të ri në konsolidimin e mëtejshëm të këtyre arritjeve dhe në shndërrimin e Kosovës në një faktor edhe më të rëndësishëm paqesje e stabiliteti dhe promovuese të miqësisë e të bashkëpunimit në rajon“, shprehet Berisha në telegramin e tij të urimit. Berisha theksoi se qeveria shqiptare „dhe unë personalisht jemi tërësisht të angazhuar dhe të vendosur për të ndërtuar marrëdhëniet më të shkëlqyera e vëllazërore dhe për të shndërruar bashkëpunimin e ngushtë e të gjithanshëm ndërmjet të dyja vendeve në shembullin më kuptimplotë të bashkëpunimit, në shërbim të forcimit të paqes, promovimit të miqësisë, zhvillimit e mirëqenies jo vetëm të kombit shqiptar, por të të gjithë popu-

jve të rajonit, si dhe për ecjen përpara në rrugën e përbashkët euroatlantike. Duke shprehur t'iu pres së shpejti në Tiranë, dëshiroj t'ju ripohoj sigurimet e konsideratës sime më të lartë“, përfundon mesazhi i kreu të qeverisë drejtuar Pacollit.

Ndërsa në urimin dërguar kryeministrin Thaçi, Berisha ka thënë se është thellësisht i bindur se Qeveria do të çojë më tej arritjet e rëndësishme e historike që shteti më i ri i Evropës, Republika e Kosovës, dhe qytetarët e Kosovës kanë shënuar gjatë kësaj periudhe. Berisha theksoi se detyrat e rëndësishme para kryeministrin, Qeverisë dhe mbarë spektër politik të Kosovës kërkojnë vazhdimin në të ardhmen të përpjekjeve të mëdha e gjithëpërfshirëse për realizimin e njohjes së plotë të Republikës së Kosovës, për zhvillimin ekonomik e të gjith-



anshëm të saj, integrimin në NATO dhe faktor edhe më të rëndësishëm të paqes BE, si dhe konsolidimin e vendit në një të bashkëpunimit në rajon.

Presidenti Behxhet Pacolli dhe kryeministri Thaçi e nisin detyrën me homazhe e zotime

Një ditë pas zgjedhjes së tyre në postet e reja, presidenti dhe kryeministri i Kosovës kanë filluar dje axhendën e tyre zyrtare duke u zotuar se do të punojnë për forcimin e shtetit të Kosovës. Presidenti Behxhet Pacolli nisi detyrën me homazhe te varri i presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova, kurse kryeministri Hashim Thaçi mblodhi Qeverinë e re në takimim parë

Me homazhet e bëra te varri i presidentit Ibrahim Rugova, pastaj te kompleksi memorial „Adem Jashari“ në Prekaz, varrezat e dëshmorëve në Gllgjan dhe homazhet te varri i Heroit të Kosovës, Zahir Pajaziti në Orllan, Behxhet Pacolli filloi edhe zyrtarisht punën dhe agjendën e tij në postin e presidentit të Kosovës. I bindur se do të luajë rol unifikues, siç e parashihet edhe Kushtetuta postin e presidentit, Pacolli tha se do ta vazhdojë rrugën e nisur nga presidenti i ndjerë Ibrahim Rugova, për forcimin e shtetit të pavarur të Kosovës. „Jam më se i përgatitur që të çoj përpara idenë e tij (Rugovës) për forcimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Ka shumë punë për të bërë dhe asnjëherë s'kam qenë më i gatshëm sesa tani për të vepruar“, tha Pacolli. Po të martën edhe kryeministri Hashim Thaçi thirri mbledhjen e parë të Qeverisë së re të Kosovës. Para kabinetit të ri qeveritar, ai tha se ky koalicion i miratuar tashmë edhe nga Kuvendi, paraqet qeverinë më të besueshme që ka pasur ndonjëherë Kosova. Kryeministri Thaçi tha se agjenda e punës së kësaj qeverie do të jetë demokratizimi, zhvillimi ekonomik, mirëqenia sociale, si dhe procesi i integrimeve evropiane. „Do t'i kryejmë me përgjegjësinë më të lartë të gjitha angazhimet që kemi marrë në përputhshmëri me legjitimitetin dhe vullnetin e qytetarëve të vendit. Kjo është qeveria që i duhet Kosovës, kjo është qeveria më kredibile që ka pasur në historinë politike Republika e Kosovës“, u shpreh Thaçi. Përveç angazhimeve në planin e brendshëm, faktori ndërkombëtar priti formimin e Qeverisë së Kosovës që të shtyjë përpara edhe nisjen e bisedimeve Kosovë - Serbi. Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi tha se Kosova do të jetë e



përgatitur për këto bisedime, ndërkaq është shprehur kundër negociimit të ndonjë zgjidhjeje për veriun e Kosovës që nuk parashihet me Kushtetutë dhe me Pakon e Ahtisarit. „Mendoj se Kushtetuta dhe Pakoja e Ahtisarit janë të përcaktuara qartë dhe janë të arritura pas një kompromisi të gjatë dhe pas bisedimeve të gjata që ishin në Vjenë, si dhe pas një zotimi të plotë të institucioneve të vendit, po edhe pajtueshmërisë ndërkombëtare. Tani kemi nevojë se si t'i rregullojmë raportet Kosovë - Serbi dhe t'i ndihmojmë rajonit për integrimin në BE, por jo për raporte brenda Kosovës apo brenda Serbisë“, theksoi Kuçi. Ndryshe, zyrtarë ndërkombëtarë paralajmëruan si mundësi që Prishtina dhe Beogradi të nisin bisedimet qysh në prill. Tani pas formimit të Qeverisë, Prishtina besohet se shumë shpejt do ta caktojë dhe shefin e delegacionit për këto bisedime, si dhe do t'i formojë ekipet

punuëse.

Tendencë - BE mirëpret formimin e institucioneve të Kosovës

Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian, Catherine Ashton, dhe komisionari i BE-së, për zgjerim, Stefan Fule, kanë mirëpritur nëpërmjet një deklaratë të përbashkët formimin e qeverisë së re të Kosovës dhe zgjedhjen e presidentit. „Ne presim të bashkëpunojmë për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës dhe të ndihmojmë në pëmbushjen e perspektivës evropiane të Kosovës. Ne gjithashtu presim nga qeveria e re që të trajtojë prioritetet në reforma. Posaçërisht kërkojmë që të përfordhet administrata publike, të shtrihet sundimi i ligjit dhe të sigurohet integrimi i të gjitha komuniteteve“, thuhet në deklaratë, raporton REL. Të dy përfaqësuesit e lartë evropianë gjithashtu kanë pohuar se mirëpresin „përkushtimin e qeverisë së re ndaj dialogut mes Prishtinës e Beogradit“.

Zgjedhja e presidentit-opozita kërcënon me Gjykatë Kushtetuese

Përfaqësuesit e partive politike opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kanë paralajmëruar se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për të kërkuar mendimin e saj se a është shkelur Kushtetuta apo jo, gjatë seancës së zgjedhjes së presidentit të Kosovës. Lidhja Demokratike e Kosovës ka vlerësuar se në bazë të zhvillimit të seancës së djeshme të Kuvendit të Kosovës, ku është votuar për presidentin, „është shkelur Kushtetuta e Kosovës“. Kujtim Shala përgjegjës për informim i kësaj partie, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se LDK-ja, votimin e djeshëm e konsideron si jokushtetues. „LDK-ja, institucionet e dala nga seanca e djeshme, i konsideron jolegjitime. Për këtë ne do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për të kërkuar mendimin e kësaj gjykate se a është shkelur Kushtetuta apo jo. Ky është qëndrimi ynë dhe ne do t'i përfillim të gjitha procedurat dhe do t'i pëmbushim të gjitha kriteret për të kërkuar mendimin e Gjykatës Kushtetuese“, i ka thënë Radios Evropa e Lirë, Kujtim Shala. Shala nuk ka saktësuar se kur do t'i bëhet kjo kërkesë Gjykatës Kushtetuese. Nga ana tjetër, Glauk Konjufca, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës nga Lëvizja Vetëvendosje, ka thënë se lëvizja e tyre ende nuk ka një vendim të prerë se a do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por, sipas tij, një gjë është e sigurt - se Kushtetuta e vendit është shkelur në Kuvendin e Kosovës. „Ne ende nuk kemi marrë vendim. Por, ajo që ne jemi të sigurt është se gjithsesi që Kushtetuta është shkelur, aq më tepër që mënyrë të hapur dhe publike është pranuar nga kryeparlamentari“, është shprehur Konjufca. Konjufca ka deklaruar, po ashtu, se Vetëvendosja është duke mbledhur edhe fakte të tjera të shkeljes së Kushtetutës nga ana e zyrtarëve të institucioneve të vendit dhe më pas, ka thënë ai, do të vendoset se çka do të bëhet me ato dëshmi. „Konsiderojmë se shkelje ka pasur që prej 18 shkurtit, kur jashtë ligjit është emëruar Hashim Thaçi si mandatar - gjë që mendojmë se edhe aty është shkelur Kushtetuta. Edhe shkeljet e seancës që kanë ndodhur dhe të gjitha këto do t'i procedojmë edhe do të marrim vendim se a do të shkojmë në fazën e Gjykatës Kushtetuese apo jo“, ka thënë Konjufca. Për Konjufcën, Pacolli si president dhe po ashtu edhe Thaçi si kryeministër nuk janë në politikë për të mirën e Kosovës, por të dy, sipas tij, janë e keqja e Kosovës në rrafshin politik e ekonomik. „Behxheti i frikësohet Thaçit, kurse Thaçi i do paratë e Behxhet Pacollit. Hashim Thaçi gjatë fushatës zgjedhore thoshte se nuk do të bënte koalicion me titistë, por në fund ai bëri koalicion me të vetëquajturin Tito i Kosovës. Vetëvendosje është kundër Titos dhe kundër kryeministrit të Titos, ka deklaruar Konjufca. Ndërkaq, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka paralajmëruar, po ashtu, se do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, sa më shpejt që të jetë e mundur, për mënyrën e votimit të presidentit. Ahmet Isufi, nënkryetar i AAK-së, ka thënë se „ngjarjet e djeshme në Kuvendin e Kosovës i kanë dhënë një hije të keqe jo vetëm institucionit, por edhe asaj për çka kemi luftuar dhe punuar tash e një dekadë. „Ne do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese, sepse me këtë ne mendojmë që i shërbejmë vendit, i shërbejmë edhe demokracisë, të cilën duhet ta kemi për qytetarët e Kosovës. Dhe, këtë do ta bëjmë sa më shpejt që të jetë e mundur“, ka pohuar Isufi nga AAK-ja. Në një takim me gazetarët, zoti Isufi ka theksuar se në këtë formë është dhunuar demokracia në Kuvend dhe se AAK-ja nuk do të lejojë, siç është shprehur ai, diktaturë në vend, e as imponime e dirigjime në Kuvendin e Kosovës. „AAK-ja do t'i përdorë të gjitha metodat demokratike për të treguar para qytetarëve të Kosovës dhe para botës demokratike se nuk lejon diktaturë në vend, nuk lejon imponime në Kuvend, sepse e dini që tre vjet me radhë dikush e ka dirigjuar nga prapaskena Kuvendin“, ka thënë Isufi. Zyrtarët e Institutit Demokratik të Kosovës, institut ky që monitoron punën e Kuvendit, kanë reaguar duke thënë se gjatë votimit për zgjedhjen e presidentit të Kosovës, është shkelur Kushtetuta dhe Rregullorja e punës së Kuvendit. Driton Selmanaj ka nënvizuar: „Ne konsiderojmë se liria e shprehjes dhe e qasjes së deputetëve është cenuar dhe mënyra se si është ndërprerë seanca plenare, na bën të besojmë që deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk ndihen të lirë për të votuar për preferencat e tyre politike“. Të tri partitë politike opozitë, LDK, Vetëvendosje dhe AAK, kanë braktisur sallën e Kuvendit gjatë procedurave të votimit për zgjedhjen e presidentit dhe Qeverisë.



AKEP: Nga 1 marsi ulen tarifat me shumicë

Që nga 1 Marsi tarifat do të nisë një ulje e re e tarifave me shumicë të telefonisë celulare, që do të vazhdojë për katër vjet dhe do t'i çojë tarifat drejt kostos efektive. Altin Rrapaj, drejtor i Rregullimit të Tregut në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, thotë se ulja e tarifave me shumicë do t'ju krijojë operatorëve hapësirën për të konkurruar me tarifa më të ulëta për thirrjet midis rrjeteve të ndryshme. AKEP ka vendosur gjithashtu t'ju kërkojë operatorëve celularë të ulin tarifat me

shumicë edhe për mesazhet e shkruara, tarifa që sot janë shumë më të larta se kostot. Për mesazhet e shkruara fillimisht vendimi do të ketë vetëm vlerë rekomanduese, deri në kryerjen e shpejtë të një analize tregu që është kërkesë ligjore për t'i dhënë vendimit vlerë detyruese. Vitet e fundit tarifat e thirrjeve brenda rrjeteve kanë njohur ulje të ndryshme, ndërkohë që vendimi i fundit i AKEP synon të çojë drejt uljes tarifave ndërmjet rrjeteve të ndryshme, që vazhdojnë të jenë shumë të larta.

Tafaj: Edukim intensiv për këshillimin e karrierës me nxënësit e klasës së nëntë

Ministri i Arsimit dhe Shkencës: Projekte e investime për Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditimit, në Arsimin e Lartë

Ministri i Arsimit dhe Shkencës Myqerem Tafaj bashkëbisedoi në një takim pune me drejtuesit e shkollave profesionale në Shqipëri. Prioritet i arsimit e ka cilësuar Ministri Tafaj, arsimin profesional, duke theksuar se do të vazhdojë mbështetja nga donatorët, por duhet menduar për çdo shkollë profesionale që kemi aktualisht se si duhet zhvilluar e transformuar në të ardhmen. Ministri Tafaj tha se, duhet menduar që ti hapim shkollat e mesme profesionale drejt ekonomisë dhe sektorit privat të interesuar. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj, deklaroi se është biseduar me Ministrinë e Financave dhe është rënë dakord që çdo shkollë të ketë llogarinë e saj, për të mundësuar zhvillimin e veprimtarive, të ardhurave për shkollat, si pasojë dhe autonominë financiare. Tashmë Bordi i këtyre shkollave profesionale, theksoi Ministri Tafaj, sipas ligjit do të ketë përfaqësues të sektorit privat. Ka plot biznesmenë, u shpreh Ministri, që duan të na ndihmojnë dhe ne duhet ti ofrojmë ato. Do të jetë bordi që bën mbikëqyrjen financiare, menaxhimin e buxhetit, si dhe kontribuon direkt në planin e zhvillimit të shkollës. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj tha se, ka rëndësi të madhe si të tërheqim nxënësit në Arsimin Profesional. Kjo tha Tafaj është e vështirë, ngaqë ne ende nuk kemi një kriter të shpallur se cili nxënës do shkojë në shkollë të mesme të përgjithshme apo në shkollë profesionale. "Thembra e Akilit" tek shkollat profesionale, theksoi Ministri Tafaj është aftësi praktik, e këtu kemi ngërçin më të madh. Në mjaft shkolla janë bërë përmirësime të mëdha, në burime njerëzore, por dhe infrastrukturë theksoi Ministri Tafaj. Çështja është theksoi Ministri, si duhet t'i



qasemi në nxënësit të klasës së nëntë. Qasja jonë është një qasje e vështirë, por duhet të jetë një qasje. Duhet të bashkëpunoni fort me DAR udhëzoi Ministri Tafaj, dhe shkollat për të patur prurje nxënësish, duke i sjellë ata në shkollë. Për këtë deklaroi Ministri duhet të përgatiten mirë, që të bëni biseda tërheqëse me prindërit, por duhet të bindni më së pari mësuesit tuaj, që të jenë ata të bindur se shkolla juaj është e mirë. Ministri i Arsimit dhe Shkencës Myqerem Tafaj theksoi si rëndësi të veçantë marketingun, për atë që ofron shkolla profesionale, çfarë fitojnë nxënësit. Ky marketing, tha Ministri Tafaj, duhet të jetë shumë aktiv, i mirëpërgatitur. Arsimi profesional u shpreh Ministri Tafaj rrit shanset për punësim gati dy here dhe është e domosdoshme që të thërrisni pranë shkollës, njerëzit nga biznesi.

Takimi për "Sigurimi i Cilësisë dhe Akreditimit, në Arsimin e Lartë"

Gjithashtu ministri Arsimit dhe Shkencës Myqerem Tafaj mori pjesë në seminarin rajonal me teme "Sigurimi i Cilësisë dhe

Akreditimit, në Arsimin e Lartë". Në fjalën e tij përshëndetëse Ministri Myqerem Tafaj falenderoi pjesëmarrësit, i uroi ata për zhvillimin e këtij seminari për një temë shumë aktuale. Kjo temë tha ministri Tafaj, është shumë aktuale për shumë shkaqe që lidhen jo vetëm me zhvillimin tërësor të brendshëm në çdo vend të rajonit, por edhe me zhvillimin ekonomik dhe të tregut të punës në mbarë rajonin dhe më gjërë, si dhe me karakterin gjithnjë e më global që po merr arsimi i lartë. Ministri Arsimit dhe Shkencës Myqerem Tafaj theksoi se Qeveria ka përcaktuar si objektiv kryesor në fushën e arsimit të lartë rritjen e Cilësisë së studimeve universitare dhe orientimin e tyre drejt kërkesave të ekonomisë dhe të tregut të punës. Rritja e aksesit në arsimin e lartë tha Tafaj përbën vetëm hapësirën për krijimin e potencialit të nevojshëm njerëzor të shkolluar të vendit. Cilësia e shkollimit përcakton nëse kjo hapësirë do të krijojë një potencial të vërtetë njerëzor të mirëshkolluar që do t'i paraprijë zhvillimit të shpejtë ekonomik dhe shoqëror të një ven-



di që synon të integrohet në BE. Ministri Arsimit dhe Shkencës Myqerem Tafaj u shpreh se "Për kontekstin e këtij seminari, dëshiroj të nënvizoj rolin shumë të rëndësishëm të internacionalizimit të studimeve dhe bashkëpunimit intensiv internacional të shkollave tona të larta. " Tafaj përmendi si faktor parësor të cilësisë burimet njerëzore, duke thënë që cilësia fillon në qelizën bazë, orën e mësimin dhe ka si aktorë pedagogun që zhvillon mësim dhe studentët e tij. Dhe kjo në fakt kjo është qeliza bazë e vërtetë edhe e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit. Tafaj deklaroi gjithashtu se për module dhe drejtime të reja të studimeve është e nevojshme të thirren edhe pedagogë nga jashtë dhe shumë i dëshiruar do të ishte bashkëpunimi midis universiteteve për të ofruar studime dhe diploma të përbashkëta, veçanërisht në nivelin e Masterit dhe të Doktoratës. Përmes një projekti, të mbështetur edhe nga BB, po krijohet një njësi e veçantë pranë APAAL për vlerësimin periodik dhe renditjen e programeve të stu-

dimeve duke marrë si bazë fillestare renditjen e programeve në katër fusha kryesore. Kjo DATABASE do t'i shërbejë në radhë të parë informimit të plotë të studentëve mbi ofertën akademike të çdo shkolle të lartë. Në kuadër të Reformës së Financimit të AL, theksoi Ministri Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj, do të ndërmerret në bashkëpunim me ekspertë dhe agjenci të huaja, vlerësimi dhe akreditimi i shkollave të larta private, si parakusht bazë për të fituar të drejtën e pranimin të studentëve që përfitojnë financim (bazë apo si subvencionim i interesit të kredisë) nga fonde publike. Ndërsa kushti tjetër u shpreh Tafaj është statusi i një IAL jofitimprurëse. Një zhvillim tjetër që i shërben Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit theksoi Ministri Arsimit dhe Shkencës Myqerem Tafaj është projekti për ngritjen e Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Informacionit për sistemin e AL, i cili, në thelb, nënkupton krijimin e një DATABASE që do të përfshinte të gjithë studentët që pranohen dhe diplomohen në shkollat e larta të vendit.

Janar, doganat arkëtojnë mbi 7.9 miliardë lekë

Administrata doganore shqiptare gjatë muajit Janar arkëtoi në buxhetin e shtetit 7.933 miliardë lekë nga 7.895 miliardë të planifikuara, me një rritje prej 38 milionë lekë. Sipas Statistikave zyrtare, krahasuar me Janarin 2010, gjatë muajit të parë të vitit

2011 janë mbledhur 867 milionë lekë më tepër. Eksportet shqiptare gjatë muajit Janar kanë rritje në sasi e vlerë krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2010. Kështu volumi i eksporteve shqiptare shprehur në sasi është 230 mijë ton nga 102.8 mijë ton

të regjistruar me të njëjtën periudhë të një viti më parë me një rritje prej 127.2 mijë ton ose 123.7% më shumë. Ndërsa si vlerë, eksportet llogariten 7.8 miliardë lekë. Rieksportet nga Përpunimi Aktiv gjatë këtij muaji kanë shënuar gjithashtu rritje në vlerë

krahasuar me muajin Janar të vitit 2010. Vlera e rieksporteve nga përpunimi aktiv është realizuar një volum në vlerën prej 6.9 miliardë lekë me rritje prej 0.9 miliardë lekë ose 14.5 % më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010.

Rritja ekonomike është mbështetur kryesisht nga kërkesa e huaj për eksportet shqiptare

Fullani: Ekonomia ka vijuar të rritet

dhe gjatë 3-mujorit të katërt 2010-



S
Në tërësi, rritja ekonomike botërore pritet të mbetet në nivele të larta edhe për periudhën në vazhdim, duke kontribuar gjithashtu në nxitjen e presioneve inflacioniste dhe duke rritur vëmendjen e autoriteteve monetare ndaj ekuilibrave makroekonomikë

faktorë kanë dhënë një kontribut prej rreth 80 për qind në formimin e shifrës së inflacionit. Rritja e çmimeve të produkteve bujqësore ka prekur më shumë shtresat me të ardhura të ulëta të shoqërisë shqiptare. Ashtu siç e theksova edhe më parë, presionet inflacioniste në vend kanë natyrën e goditjeve afatshkurtra të ofertës, ndërsa inflacioni i gjeneruar nga kërkesa e brendshme është i ulët, siç reflektohet edhe në ecurinë relativisht të qëndrueshme të inflacionit bazë. Kjo ecuri kushtëzohet nga ekzistenca e kapaciteteve të pasfrytëzuara në ekonominë shqiptare si dhe ekspansioni i kontrolluar monetar dhe pritjet e ankoruara inflacioniste të konsumatorëve, të biznesit e të agjentëve të tregut financiar. Banka e Shqipërisë gjykon se, në vija të përgjithshme, këta faktorë do të vazhdojnë të jenë të pranishëm edhe gjatë vitit 2011 – tha Fullani. Më tej guvernatori shtoi se: - “Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë në parashikimin e inflacionit në të ardhmen ka faktorizuar edhe parashikimet e deritanishme të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatës Botërore të Ushqimit për ecurinë e naftës dhe mallrave ushqimorë. Në mungesë të goditjeve të shtuara dhe të parapashikueshme nga ana e ofertës apo të shfaqjes së fenomeneve zinxhir të raundit të dytë, ecuria e inflacionit pritet të jetë në linjë me objektivin e Bankës së Shqipërisë”. Në vijim të fjalës së tij Fullani paraqiti një analizë më të detajuar të zhvillimeve aktuale e të pritshme në ekonominë shqiptare e në tregjet financiare, duke vlerësuar edhe implikimet e tyre për ecurinë e pritit të inflacionit të çmimeve të konsumit.

Aktiviteti ekonomik

Në mungesë të të dhënave direkte dhe duke gjykuar mbi një sërë treguesish të tërthortë, Banka e Shqipërisë vlerëson se ekonomia shqiptare ka vijuar të rritet edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2010. Rritja ekonomike është mbështetur

brendshme. Korrektimi i sjelljes fiskale është shoqëruar me një kontribut më të ulët në rritjen ekonomike përgjatë vitit 2010. Kështu, **shpenzimet publike** janë tkurrur me rreth 5% në terma vjetorë, ndërsa deficitit buxhetor është ulur me rreth 4 pikë përqindjeje të PBB-së. Banka e Shqipërisë është eliminuar nga lista e vendeve të drueshmëria fiskale është një parakusht themelor për një rritje afatgjatë ekonomike. Në këtë kontekst, ne mendojmë se respektimi i objektivave të buxhetit për deficitin buxhetor dhe huamarrjen publike gjatë vitit 2011 do të japë një kontribut pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit. Ruajtja e niveleve relative të deficitit buxhetor do të eliminojë ndikimin negativ direkt në rritjen ekonomike, ndërsa nivelet relativisht të ulëta të huamarrjes publike do të ndikojnë në kontrollin e normave afatgjata të interesit dhe uljen e primeve të rrezikut në tregjet financiare.

Këto zhvillime u manifestuan gjatë gjysmës së dytë të vitit 2010 dhe pritet të nxitin kërkesën e brendshme edhe gjatë vitit të 2011.

Sektori i jashtëm i ekonomisë ka vijuar të karakterizohet nga një kontribut pozitiv, por në rënie, i kërkesës së huaj në rritjen ekonomike. Ritmi i korrektimit të deficitit tregtar është zbehur në këtë tremujor. Deficitit tregtar është ulur me 1.2% kundrejt normave dyshifrore të korrektiveve të regjistruara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010. Kjo ecuri e deficitit tregtar është përcaktuar kryesisht nga përshpejtimi i importeve, të cilët shënuan një rritje vjetore prej 10.8% në tremujorin e katërt të vitit 2010, duke regjistruar njëkohësisht rritje për të tretin tremujor radhazi. Nga ana tjetër, eksportet shqiptare u rritën me 48.8% në terma vjetorë, duke ruajtur ritme të larta rritjeje. Banka e Shqipërisë gjykon se ekonomia shqiptare do ta ketë të vështirë të ruajë të njëjtat norma rritjeje të eksporteve edhe gjatë vitit 2011; ndër të tjera ky parashikim reflekton faktorët e përkohshëm që ndikuan në rritjen e vitit 2010 dhe është në linjë me ecurinë e ekonomisë botërore dhe me efektet bazë statistikore. Megjithatë, kërkesa e huaj pritet të japë një kontribut pozitiv në rritjen ekonomike edhe gjatë vitit 2011.

Treguesit monetarë, tregjet financiare dhe inflacioni

Ecuria e treguesve monetarë vazhdon të prodhojë presione të kontrolluara inflacioniste me natyrë monetare në ekonominë vendase. Oferta monetare u rrit me 12.5% në muajin dhjetor të vitit të kaluar, duke reflektuar ecurinë e mirë të depozitave të sistemit bankar gjatë gjithë gjysmës së dytë të këtij viti.


Vlerësimi i natyrës së zgjerrimit monetar është në përputhje me kërkesën e sektorit privat të ekonomisë për para reale. Ecuria e mirë e aktivitetit ekonomik dhe primet në rënie të rrezikut janë reflektuar edhe në rritjen e kërkesës për kredi të sektori privat. Parametrat e kënaqshëm të sistemit bankar në terma të likuiditetit dhe të kapitalizimit kanë

kontribut pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit. Ruajtja e niveleve relative të deficitit buxhetor do të eliminojë ndikimin negativ direkt në rritjen ekonomike, ndërsa nivelet relativisht të ulëta të huamarrjes publike do të ndikojnë në kontrollin e normave afatgjata të interesit dhe uljen e primeve të rrezikut në tregjet financiare. Në tregun ndërbankar, normat afatshkurtra të interesit kanë qëndruar pranë normës bazë të interesit dhe kanë shfaqur luhatshmëri të ulët. Tregtimi i valutës në tregun vendas ka qenë gjithashtu i qetë. Leku ka vijuar të nënçmohet në terma nominalë vjetorë kundrejt monedhave të huaja, por me ritme më të buta krahasuar me vitin 2010. Duke vënë në balancë informacionin e përmbledhur më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se presionet inflacioniste në periudhën afatmesme mbeten të kontrolluara. Ecuria e çmimeve të konsumit në të ardhmen pritet të jetë nën presionin e rritjes së çmimeve në tregjet botërore, por, në mungesë të efekteve të raundit të dytë, ndikimi i tyre pritet të jetë kalimtar. Nga ana tjetër, kërkesa ende e pamjaftueshme do të vazhdojë të kushtëzojë nivele nën potencial të shfrytëzimit të kapaciteteve në vend, duke ushtruar presione në kahun rënës mbi inflacion. Pritjet inflacioniste vazhdojnë të jenë të ankoruara rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë për inflacionin. Në mungesë të goditjeve të papritura, inflacioni pritet të jetë afër objektivit të Bankës së Shqipërisë në periudhën afatmesme. Banka e Shqipërisë, në vazhdim, do të monitorojë natyrën e këtyre goditjeve të jashtme dhe përcjelljen e tyre në çmimet në vend, për të reaguar në kohë me qëllim eliminimit e presioneve të qëndrueshme inflacioniste. Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës konkludoi se kushtet monetare paraqiten të përshtatshme për respektimin e objektivit të inflacionit në periudhën afatmesme dhe vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5.00 për qind.

Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

STALINI I RI




Pas suksesit me "Stalini në oborrin e Carit të kuq", me autor Simon Sebag Montefiore, Shtëpia Botuese "55" hedh në treg një tjetër libër të famshëm të këtij autori "Stalini I ri", fitues i çmimit "Costa Biography Award", 2007

Botimet e reja

Shtëpia Botuese "55"

Ribotimi

"Zonja e Zezë..." e Fahri Balliut, në ribotimin e 9-të të saj



Në libraritë kryesore të vendit, është hedhur në qarkullim ribotimi i 9-të i best-sellerit "Zonja e Zezë Nexhmije Hoxha", të publicistit Fahri Balliu, me parathënieën e shkrimtarit Ismail Kadare. Publikimi është i pajisur edhe me shënimin e fundit të autorit, për lumin e fakteve të reja për karakterin kriminal të personazhit kryesor të monografisë


Botimet e reja

Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

Komploti kundër Kishës

[Shtëpia Botuese 55 sjell për lexuesin një nga librat me te debatuar mbi historinë e Kishës Katolike]



Ky libër, historikisht i rëndësishëm, do të sulmohet, me të gjitha mundësitë, si antisemitik. Librin rrefen se, hebrenjtë kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm, dhe, jo gjithnjë të dobishëm, në të gjithë historinë e njerëzimit e kjo është e dukshme; që veprimtaria e tyre nuk ka qenë gjithnjë miqësore kundrejt Krishtërit dhe popujve johebrenj, është, gjithashtu, e dukshme, dhe ka një fond të jashtëzakonshëm evidencash nga burime judaike e të tjera, të autoritetit të palëkundur, që e provon këtë

Albanian Airlines
Spirit of Albania

**BOLONJA
TORINO
PISA
BERGAMO
VERONA
STAMBOLL
ANTALJA
FRANKFURT
LONDER**

Destinacionet tona

Fluturoni me ne
www.albanianair.com
info@albanianair.com

E thjeshtë sa një ëndërr

Qeveria miraton fondin prej 1.36 miliardë lekë, për dëmbshpërblimin e ish-të dënuarve politikë e .455 ish-të dënuarve politikë

Këshilli i Ministrave miratoi dje një tjetër vendim për dëmbshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist. Vendimi përcakton masat e dëmbshpërblimit për 455 ish-të dënuar politikë të regjimit komunist, kërkesat e të cilëve kanë përmbushur kriteret ligjore dhe që kanë vuajtur

dënimin e kryer me burg nga data 30. 11. 1944 deri më 01. 10. 1991, si dhe për familjarët e të dënuarve me dënim kapital (të pushkataro apo të ekzekutuar). Shuma e masave financiare e përlogaritur sipas këtij vendimi, në total është 1 355 457 123 lekë. Lidhur me këtë vendim, Kryeministri Ber-

isha tha se qeveria vazhdon disbursimet financiare të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, në përputhje me programin e premtuar. Po dje, qeveria miratoi edhe vendimin për miratimin e strukturës dhe të Organikës së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

Nr.	Emër	Mbiemër	Përfitimet nga ligje të mëparshme					Dëmbshpërblim përfundimtar
			Shuma e dëmbshpërblimit në lekë	Ministria e Financës		Enti Komëtar i Banesave	Z.Q.R.P.P	
				Lekë	Letra me Vlerë			
1	Kola	Dalla	8,502,000	85,000	928,768	0	0	7,488,232
2	Muskli	Mahmuti	8,590,000	0	1,412,400	0	0	7,177,600
3	Cemal	2,526,000	250,000	3,300,000	0	0	1,976,000	
4	Marka	Ramaj	2,920,000	0	480,000	0	0	2,440,000
5	Haska	Hajaj	1,874,000	100,000	206,982	0	0	1,567,018
6	Vasil	Papa	3,434,000	75,000	0	0	0	3,359,000
7	Sherif	Çala	2,670,000	0	435,825	0	0	2,234,175
8	Ferat	Mollaj	694,000	200,000	50,000	0	0	444,000
9	Lube	Burgaj	4,934,000	100,000	708,006	0	0	4,125,994
10	Deđ	Fushashia	2,348,000	50,000	380,000	0	0	1,918,000
11	Agim	11,278,000	0	183,413	0	0	944,587	
12	Eltan	Bezo	2,248,000	0	370,192	0	0	1,877,808
13	Tahir	Protodhari	2,168,000	0	354,740	0	0	1,813,260
14	Ferjo	Avdyli	1,002,000	0	50,000	0	0	952,000
15	Lamçe	Hoxhaj	5,110,000	0	800,000	0	0	4,310,000
16	Besnik	Alia	2,916,000	0	520,000	0	0	2,396,000
17	Myrir	Sopoti	4,608,000	100,000	948,000	0	0	3,560,000
18	Hair	Kondi	2,100,000	100,000	343,476	0	0	1,656,524
19	Jakup	Dedej	996,000	0	0	0	0	996,000
20	Teki	Dalip	3,650,000	0	600,220	0	0	3,049,780
21	Ndçe	Peci	2,190,000	0	360,000	0	0	1,830,000
22	Riza	Dumazeti	1,460,000	0	240,000	0	0	1,220,000
23	Hysni	Smajli	1,966,000	0	0	0	0	1,966,000
24	Sherife	Deko	11,902,000	0	1,800,000	0	0	10,102,000
25	Beshin	Peraku	272,000	0	183,800	0	0	83,200
26	Ismail	Mezani	1,114,000	200,000	80,493	0	0	833,507
27	Najlo	Priiti	622,000	0	100,603	0	0	521,397
28	Mehmet	Dauti	4,374,000	100,000	716,000	0	0	3,558,000
29	Petro	Nuni	5,438,000	0	804,822	0	0	4,633,178
30	Xhemali	Allamani	4,294,000	0	741,041	0	0	3,552,959
31	Orenos	Patazi	2,190,000	0	300,000	0	0	1,890,000
32	Shahin	Haschi	4,078,000	60,000	700,000	0	0	3,318,000
33	Tahir	Qunsh	1,454,000	60,000	360,000	0	0	1,034,000
34	Fazli	Shkëmbari	1,070,000	0	0	0	0	1,070,000
35	Bilbil	Dvyrnshaj	3,032,000	0	994,000	0	0	2,038,000
36	Sali	Plaka	1,434,000	0	154,340	0	0	1,279,660
37	Rstem	Cukaj	2,140,000	0	348,781	0	0	1,791,219
38	Gren	Groka	4,926,000	200,000	1,648,655	0	0	3,077,345
39	Zylio	Maqo	2,212,000	0	84,000	0	0	2,128,000
40	Beqir	Topçiu	5,164,000	100,000	744,720	0	0	4,319,280
41	Servet	Elzei	4,390,000	75,000	721,973	2,491,746	0	1,101,281
42	Pandi	Irakli	974,000	100,000	100,000	0	0	774,000
43	Cerim	Martini	6,446,000	100,000	105,000	0	6,800	6,340,200
44	Rexhep	Mitani	3,990,000	80,000	600,000	0	0	3,310,000
45	Idriz	Dauti	4,756,000	130,475	784,438	0	0	3,841,087
46	Gjok	Zefi	4,122,000	100,000	575,270	1,359,000	0	2,087,270
47	Sulejman	Mitaj	13,026,000	0	2,116,000	0	0	10,910,000
48	Nuli	Anxhara	606,000	98,301	0	0	0	807,699
49	Vidan	Balloyza	730,000	0	120,000	0	0	610,000
50	Krisio	Palla	16,000	0	2,630	0	0	13,370
51	Gjeto	Mesheraj	1,098,000	60,000	0	0	0	1,038,000
52	Demir	Kadriu	1,908,000	33,000	320,000	0	0	1,555,000
53	Pashko	Shelishita	4,430,000	90,000	720,000	0	0	3,620,000
54	Lazim	Murra	608,000	0	0	0	0	608,000
55	Anastas	Mura	2,628,000	0	717,250	0	0	1,910,750
56	Zaho	Haidzeraj	2,920,000	0	300,000	0	0	2,620,000
57	Kasem	Stafa	5,800,000	0	916,932	0	1,800,000	2,863,068
58	Tanush	Ismailati	3,650,000	36,000	599,129	0	0	3,014,871
59	Pashkë	Vuçinaj	940,000	155,178	0	0	0	784,822
60	Jak	Gjinaj	2,190,000	0	340,000	0	0	1,850,000
61	Hamid	Tabaku	696,000	0	112,438	0	0	583,562
62	Lush	Shkoza	3,470,000	100,000	467,829	0	0	2,902,171
63	Kol	Patani	6,854,000	100,000	1,000,000	0	0	5,754,000
64	Bardhok	Marku	8,072,000	363,945	2,400,000	0	0	5,268,055
65	Mehmet	Bekullaj	1,462,000	100,000	500,000	0	0	802,000
66	Premt	Nikollaj	1,786,000	0	300,000	0	0	1,486,000
67	Andrea	Hriseshaj	6,690,000	0	1,100,000	0	0	5,590,000
68	Sehat	Caushtari	3,212,000	58,000	480,242	0	0	2,673,758
69	Veronika	Tafa	304,000	69,370	0	0	0	234,630
70	Gez	Eglli	5,706,000	0	789,104	0	0	4,916,896
71	Medi	Kulla	4,122,000	100,000	600,220	850,000	0	2,087,270
72	Hysen	Greca	8,546,000	0	1,320,658	0	0	7,225,342
73	Abas	Çuka	1,814,000	0	297,863	0	0	1,516,137
74	Ibrahim	Allja	1,632,000	0	267,204	804,000	0	560,796
75	Agron	Cani	1,366,000	0	222,575	0	0	1,143,425
76	Musa	Çeliku	4,928,000	0	679,000	0	0	4,249,000
77	Dilaver	Taka	5,080,000	100,000	720,000	0	0	4,260,000
78	Allaman	Murja	5,110,000	0	838,977	0	0	4,271,023
79	Isa	Alia	1,926,000	100,000	178,879	0	0	1,647,121
80	Erver	Likmeta	2,586,000	0	1,143,225	1,517,000	0	1,069,000
81	Faqir	Çeliku	3,030,000	200,000	298,486	0	0	2,531,514
82	Mahmut	Memo	5,418,000	40,000	800,000	0	0	4,578,000
83	Kola	Velo	15,366,000	127,890	2,395,200	0	0	12,842,910
84	Shaban	Xhaka	1,908,000	50,000	337,000	0	0	1,521,000
85	Dutë	Maze	7,902,000	185,000	1,470,220	0	0	6,246,780
86	Rexhep	Xhameta	6,202,000	100,000	918,849	0	0	5,183,151
87	Xhevdet	Qutipi	486,000	100,000	27,562	0	0	358,438
88	Sherif	Bali	1,464,000	0	240,000	0	0	1,224,000
89	Hamid	Çerçani	4,236,000	0	600,000	0	0	3,636,000
90	Peter	Çiriku	5,574,000	100,000	913,781	0	0	4,560,219
91	Mahmut	Vogli	2,196,000	0	0	0	0	2,196,000
92	Ymer	Fasli	762,000	120,000	156,670	0	0	485,330
93	Ajet	Cemi	1,604,000	0	0	0	0	1,604,000
94	Rasim	Çeliku	290,000	40,338	0	0	0	250,000
95	Dal	Gjoreteaj	2,056,000	100,000	236,185	0	0	1,719,815
96	Pano	Kuro	5,880,000	100,000	850,000	0	0	4,930,000
97	Niko	Dvran	1,670,000	100,000	172,859	0	0	1,397,141
98	Koco	Qendro	3,652,000	50,000	600,328	0	0	3,081,322
99	Shupo	Macedoni	1,254,000	0	2,044,739	0	0	10,409,221
100	Xhevit	Kocaj	7,306,000	0	398,136	14,880	0	6,897,984
101	Nebi	Shehu	2,814,000	100,000	0	0	0	2,714,000
102	Fatmir	Gjeto	1,810,000	0	297,000	0	0	1,513,000
103	Mito	Shitneraj	2,000,000	1,411,419	0	0	0	8,200,581
104	Kosta	Papa	5,192,000	0	959,342	0	0	4,232,658
105	Naim	Hoxha	8,982,000	200,000	1,274,268	0	0	7,507,732
106	Esat	Ymeraj	4,092,000	0	199,800	0	0	3,892,200
107	Mark	Dremi	662,000	0	106,521	0	0	555,479
108	Arben	Tola	480,000	200,000	0	0	0	280,000
109	Ismail	Mara	3,156,000	150,000	443,226	0	0	2,562,774
110	Prekë	Verri	1,898,000	100,000	212,592	0	0	1,587,408
111	Abdulla	Shehu	704,000	0	53,810	0	0	650,190
112	Çirjako	Zoga	10,030,000	200,000	1,449,151	0	0	8,380,849
113	Rushan	Nuhu	7,586,000	0	1,351,233	900,000	0	5,334,767
114	Ramadan	Collaku	1,666,000	100,000	164,000	0	0	1,342,000
115	Ozdim	Ferizim	1,176,000	0	191,342	0	0	984,658
116	Bilshem	Çeliku	2,920,000	100,000	300,000	0	0	2,520,000
117	Sadik	Elzei	9,120,000	200,000	1,296,908	0	0	7,623,092
118	Fuat	Turani	8,408,000	200,000	1,402,902	0	0	6,805,098
119	Abdyll	Tepelja	4,448,000	78,000	101,000	0	0	4,269,000
120	Hamdi	Gosa	1,136,000	0	180,000	0	0	956,000
121	Nezir	Katshaj	1,320,000	0	251,178	480,950	0	1,068,822
122	Maliq	Koltraka	1,962,000	0	267,616	0	0	1,694,384
123	Nikolla	Zeri	3,598,000	100,000	0	0	0	3,498,000
124	Hamid	Tahirllari	5,618,000	0	922,520	0	0	4,695,480
125	Rexhep	Jazhi	2,464,000	0	1,106,600	0	0	1,357,400
126	Ismail	Laci	4,022,000	0	720,000	0	0	3,302,000
127	Muhamet	Durdija	5,120,000	0	840,658	1,135,000	0	3,144,342
128	Dië	Uci	4,326,000	200,000	509,479	0	0	3,616,521
129	Halim	Kaloshi	3,650,000	100,000	599,128	0	0	2,950,872
130	Anastas	Beslidhi	4,982,000	0	6,982,000	0	0	13,964,000
131	Muharrem	Deđa	4,262,000	100,000	988,274	241,000	0	2,962,720
132	Ali	Erebara	3,620,000	100,000	653,260	0	0	2,866,740
133	Zenel	Jupa	1,104,000	100,000	91,802	0	0	912,198
134	Hajdar	Hysa	3,660,000	90,000	60			

Ministria e Punës me mbështetjen e PNUD organizoi Konferencën “Mosdiskriminimi”

Institucionet shtetërore bashkë kundër diskriminimit

“Diskriminimi i pengon njerëzit të ushtrojnë të drejtat dhe zgjedhjet e tyre dhe kjo rezultojnë jo vetëm në pasiguri ekonomike dhe shoqërore, por prek edhe vetë respektin dhe vetëvendosjen e personit të diskriminuar”, - deklaroi Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, z. Spiro Ksera, në Konferencën Kombëtare “Mosdiskriminimi – Sfidë dhe Angazhim për Shqipërinë”, organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi me mbështetjen nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD). Ministri Ksera theksoi se sfidë e të gjitha institucioneve sot është hartimi dhe zbatimi i politikave të tilla që garantojnë de facto mbrojtjen e çdo individi dhe grupi nga diskriminimi për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzanisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicionit gjenetik, aftësisë e kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër, parashikuar edhe në Ligjin “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, miratuar një vit më parë. Në konferencë e morën fjalën



“Bota Jonë, Paqe, Sfidë dhe Integrim”, pranë fëmijëve me aftësi të kufizuara Ministria e Punës, aktivitete artistike për përfshirjen dhe integrimin e fëmijëve

Zhvillimi dhe integrimi në jetën sociale e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si fëmijët që nuk shikojnë, fëmijët që nuk dëgjojnë e nuk flasin dhe fëmijët me probleme mendore dhe fizike, janë në qendër të vëmendjes së punës dhe angazhimit të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Në këtë kuadër, me mbështetjen dhe nën kujdesin e veçantë të Ministrit Spiro Ksera dhe në bashkëpunim me Shoqatën e Spektakleve “Karabashi”, po zhvillojnë një sërë aktivitete në qendrat dhe shkollat që trajtojnë këto kategori fëmijësh nën moton “Bota jonë, Paqe, Sfidë dhe Integrim”. Aktivitete përfshijnë tra-

jime disaditore dhe ngjarje artistiko-kulturore në të cilat vetë fëmijët janë pjesëmarrës dhe protagonistë duke shfaqur vlerat dhe talentet e tyre në interpretime muzikore, valle, piktura dhe të tjerë. Koncerte gjithëpërfshirëse u organizuan edhe me fëmijët që mësojnë dhe trajtohen në shkollat speciale të fëmijëve që nuk shikojnë dhe që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin në kryeqytet. Aktiviteti “Bota jonë Paqe, Sfidë dhe Integrim” është një nismë sociale që ka për qëllim plotësimin shpirtëror dhe argëtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe ajo u vjen në ndihmë edhe intergimit social të tyre.

edhe Zj. Irma Baraku – Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi – institucion i ngritur ky për herë të parë pas miratimit të ligjit antidiskriminim, Zj. Iva Zajmi - Zv. Ministre e Brendshme e Zj. Brikena Kasmi - Zv. Ministre e Drejtë-

sive, Drejtori i PNUD-it për vendin Z. Norimasa Shimomura si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Znj Irma Baraku beri një paraqitje të punës që institucioni i saj i ri ka realizuar gjate

tim të ligjit. Pasi mori fjalën, Z. Shimomura theksoi angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë me nënshkrimin e një sere konventash si dhe detyrimet që diktohen nga legjislacioni i Bashkimit Europian. Ai inkurajoi autoritetet shqiptare të punonin për rishikimin e gjithë legjislacionit nga këndvështrimi i parimeve të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, si dhe për të punuar për realizimin në praktike të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ai gjithashtu i siguroi pjesëmarrësit për ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme të UNDP-se përgjatë këtij procesi. Funkcionaret e tjerë që e morën fjalën, theksuan veprimtaritë e ndërmarra deri me sot nga institucionet e tyre për të siguruar me mire zbatimin e këtij ligji të ri dhe evidentuan sfidat e ndeshura në këtë rrugë.

Lista nr. 14 e ish të dënuarve, të cilët janë dënuar me dënim kapital									
Nr.	Emër	Mbiemër	Viti i vdekjes	Shuma e dëmshpërblimit në lekë	Përfitimet nga ligje të mëparshme				Dëmshpërblimi përfundimtar
					Ministria e Financës		Enti Kombëtar i Banesave	Z.Q.R.P.P	
					Lekë	Letra me Vlerë			
1	Kalem	Zogu	21.01.1947	5,840,000	600,000	720,000	0	0	4,520,000
2	Dylber	Llapanj	30.08.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
3	Habil	Vrako	12.10.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
4	Faredin	Jahja	17.08.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
5	Het'hem	Lamçe	30.06.1945	5,840,000	200,000	720,000	1,634,000	0	3,286,000
6	Riza	Isufaj	15.12.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
7	Shefki	Kreka	25.06.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
8	Llesh	Mëlyshi	16.08.1949	5,840,000	400,000	1,010,630	0	0	4,429,370
9	Musa	Kërma	30.07.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
10	Çesk	Çoba	30.03.1954	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
11	Mihal	Cini	25.01.1960	11,522,000	200,000	720,000	0	0	10,602,000
12	Isa	Vrenozi	20.08.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
13	Hulusi	Velaj	28.04.1951	5,840,000	0	718,560	0	0	5,121,440
14	Hariz	Mema	30.08.1945	5,840,000	200,000	0	0	0	5,640,000
15	Dervish	Devishi	28.05.1945	5,840,000	200,000	718,560	0	0	4,921,440
16	Sejfulla	Shima	01.02.1951	9,432,000	400,000	720,000	0	0	8,312,000
17	Qemal	Kasaruh	01.03.1951	5,840,000	2,000,000	0	0	0	3,840,000
18	Ismail	Sali	20.10.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
19	Ali	Merkaj	1952	5,840,000	0	720,000	0	0	5,120,000
20	Harito	Bezhani	18.08.1955	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
21	Isuf	Pepmarku	18.03.1954	5,840,000	200,000	716,400	0	0	4,923,600
22	Harallamb	Papa	16.05.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
23	Koço	Evangelin	06.09.1946	5,840,000	260,000	720,000	0	0	4,860,000

24	Bajram	Bajraktari	22.09.1949	5,840,000	200,000	863,342	0	0	4,776,658
25	Shyqyri	Myftiu	23.05.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
26	Nasho	Jorgo	12.09.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
27	Ramiz	Kasa	20.08.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
28	Dyle	Voci	20.05.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
29	Dalip	Merlika	31.12.1949	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
30	Faik	Shehi	05.02.1948	5,840,000	200,000	0	0	0	5,640,000
31	Janaq	Dhima	15.05.1912	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
32	Nevruz	Hysemman	31.12.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
33	Hysen	Haxhia	31.08.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
34	Hysen	Graceni	28.04.1949	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
35	Sefedin	Berhamaj	15.10.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
36	Enver	Agolli	12.04.1945	5,840,000	200,000	840,000	0	0	4,800,000
37	Man	Nezaj	19.11.1949	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
38	Xhemil	Ruka	s'ka	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000

Lista nr. 14 e ish të dënuarve të cilët kanë vlerën 0									
Nr.	Emër	Mbiemër	Shuma e dëmshpërblimit në lekë	Përfitimet nga ligje të mëparshme				Dëmshpërblimi përfundimtar	
				Ministria e Financës		Enti Kombëtar i Banesave	Z.Q.R.P.P		
				Lekë	Letra me Vlerë				
1	Sifi	Mema	338,000	54,904	0	469,000	0	0	0
2	Dod	Lulgjuraj	8,764,000	200,000	12,368,630	1,938,000	0	0	0
3	Sulejman	Feto	932,000	100,000	900,000	0	0	0	0
4	Seit	Koprencka	1,732,000	60,000	2,820,000	0	85,000	0	0
5	Llazi	Papajani	2,854,000	600,000	3,600,000	0	0	0	0
6	Muhamet	Xhaferaj	112,000	0	18,282	899,000	0	0	0
7	Mehmet	Xeka	518,000	0	600,000	0	0	0	0
8	Fran	Qepuri	554,000	100,000	900,000	0	0	0	0
9	Qerim	Kasli	104,000	100,000	100,000	0	100,000	0	0

Nga Kastriot Dervishi

60 vjet nga hedhja e bombës në Legatën Sovjetike në Tiranë

Terrorizmi i pushtetit mbi qytetarët shqiptarë

Në vitet e para të demokracisë, ndër të tjera nisi edhe një proces që synonte rehabilitimin e viktimeve të diktaturës komuniste. Në njërin prej rasteve të shumta të zbulimit të krimeve të diktaturës, ishte edhe pushkatimi i 22 qytetarëve të marrë peng nga "pushteti popullor". Rasti i zhvarrimit të asaj kohe ishte një rast i sa i dhimbshëm aq edhe i tronditës. Nuk kishte mjaftuar fakti i të marrit peng, por të 22 viktimit ishin lidhur me tel edhe përpara pushkatimit, ashtu siç u gjetën edhe eshtrat e tyre shumë e shumë vite më pas.

Rrëmbimi i personave të cilësuar kundërshtarë të regjimit, marrja peng e tyre dhe së fundi, ekzekutimi pa asnjë shkak, bazë ligjore dhe pa asnjë provë, nuk janë gjë tjetër veçse shprehje e terrorizmit të një pushteti ndaj shtetasve të vet.

Një listë e gjatë me emra kundërshtarësh të regjimit, nuk ishte e lehtë të krijohet. Pak a shumë raporti politik në vend duhej. Familjet e prekura dihehin. Ato ishin të shënjuara e përcaktuara mirë se si duheshin trajtuar.

Ishte pikërisht 19 shkurti 1951, një mbrëmje e ftohtë dimri kur, në një pjesë jo fort të rëndësishme të Legatës Sovjetike në Tiranë (sot Ministria e Arsimit), do të shkaktoheshin dëme të lehta pas shpërthimit të një sasive të vogël eksplozivi.

Prestigji i Bashkimit të madh Sovjetik ishte goditur rëndë. Sado që një veprim spontan dhe jo i organizuar siç duhet, jehona e këtij akti nuk ishte e vogël.

Menjëherë pas ngjarjes, më 20 shkurt 1951, Byroja Politike zhvilloi mbledhjen e saj në lidhje me masat që duheshin marrë. Mbledhja erdhi pas asaj të plenumit të PPSH-së. Këtu raportoi zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Brendshme, Mehmet Shehu.



Mbledhja e Byrosë Politike

(Anëtarët e Byrosë Politike: Enver Hoxha, Tuk Jakova, Mehmet Shehu, Bedri Spahiu, Hysni Kapo, Gogo Nushi, Spiro Koleka, Beqir Balluku, Liri Belishova).

Shoku Komandant (Enver Hoxha): Tani të shohim një propozim të Mehmetit, në lidhje me masat që duhet të marrim për atë që na ngjau në Legatën Sovjetike.

Shoku Mehmet Shehu: Të arrestojmë rreth 100 ose 150 veta, nga të cilët, 10 ose 15 prej tyre t'i pushkatojmë, duke zgjedhur sigurisht nga ata më kryesorët, mbasi kanë dashur të organizojnë atentate të tjera. Kjo masë do të procedohet edhe me një masë tjetër spastrimi nga Tirana, të familjeve reaksionare brenda një muaji. Ne duhet terrorit t'i përgjigjemi me terror dhe, këtë mund ta bëjmë me plot ndërgjegje e me gjakftohtësi. Ne i kemi përgatitur listat e arrestimeve dhe, po të jeni edhe ju dakord, veprojme që sonte. Qysh

këtyre do të bëjmë pastrimin që të heqim familjet e dyshimta, si dhe njerëz të tjerë që punojnë afër tyre, pse kemi vënë re që janë futur tek ata, njerëz të poshtër, dy shoferë jo të mirë. Këta masa mendojmë t'i marrim kudo ku ka sovjetikë, që janë rreth 200 veta prej tyre. Do të marrim gjithashtu, me këtë rast, edhe disa masa më të mira për mbrojtjen e legatave të demokracive popullore, të cilat, sot për sot kanë vetëm nga një roje. Megjithëse me këto masa do të bëhen edhe mjaft harxhime, ne do t'i bëjmë, se janë masa të domosdoshme dhe duhet t'i marrim.

Sabiha Kasimati, lindur në 1912 në Ankara (origjina nga Libohova). E para femër që kishte mbaruar liceun e Korçës. Kishte mbaruar Fakultetin e Shkencave Biologjike në Torino. Kishte qenë shoqe shkolle e Enver Hoxhës.

Pjerin Guraziu, lindur në Shkodër, në 1906. Në Itali kreu shkollën e lartë ekonomike, ndërsa kishte punuar në shkollën tregtare të Vlorës.



BOMBA NË AMBASADËN SOVJETIKE 1951

Gjykata e sigurimit (M. B.) Dënon me pushkatim : (Ministri Drejtësisë Manol Konomi jep dorëheqjen në shenjë proteste)



S. Kasinati



R. Selfo



H. Kodra



J. Kaceli



P. Gurakuqi



G. Temali



A. Delhysa



G. Jegeri



Th. Katundi



Z. Herri



T. Shehu



M. Jegeri



F. Dizdari



LL. Rashkoviç



M. Peshkopia



N. Lezo

PA FOTO

Q. Kasaruho
Petro KomiAli Qorraliu
Pandeli NovaHekuran Troka
Mehmet Shkupi

Anton Delhysa, lindur në Prizren, në 1904. Kreu shkollën e teknike në Tiranë. Kryetar i zyrës teknike.

Zyhdi Herri, lindur në Tiranë, në 1921. Studioi në liceun e Korçës dhe pas vitit 1939, në atë të Tiranës.

Gafur Jegeri, lindur në Dibër të Madhe, në 1908. Mbaroi akademinë ushtarake dhe punoi komandant i rojës së financës Vlorë.

Jonuz Kaceli, lindur në Tiranë. U torturua shumë gjatë procesit, aq sa thuhet se ka vdekur para ekzekutimit.

Manush Peshkopia, lindur në Vlorë, në 1912. Fitoi kulturë të gjerë, duke punuar si autodidakt. U arrestua për herë të dytë.

Mehmet Shkupi, lindur në Shkup, në 1893.

Niko Lezo, lindur në Delvinë. Krijues i të parit laborator kimik në Shqipëri. Deputet 1923 – 1925. Ndër dy deputetët që abstenojnë, më 21 janar 1925, kur u shpall Republika e parë shqiptare.

Lluka Rashkoviç, lindur në Mal të Zi, në 1900. Shofer mekanik malazez, ngelur në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore.

Haki Kodra, lindur në Dibër të Madhe, në 1921. Ushtri tregtinë në Tiranë.

Rrëmbimi i personave të cilësuar kundërshtarë të regjimit, marrja peng e tyre dhe së fundi, ekzekutimi pa asnjë shkak, bazë ligjore dhe pa asnjë provë, nuk janë gjë tjetër veçse shprehje e terrorizmit të një pushteti ndaj shtetasve të vet

Reiz Selfo, lindur në Gjirokastrë. Ushtri tregtinë. Enver Hoxha kishte shfaqur mëri personale me të.

Myftar Jegeri, lindur në Dibër të Madhe, në 1915. Akademik ushtarak. Shërbeu në forcat e armatosura.

Thoma Katundi, lindur në Katund të Korçës, në 1887. Dikur kishte qenë emigrant në SHBA dhe për këtë shkak ishte shpallur "armik".

Hekuran Troka, lindur në Kuçovë, në 1919. Tregtar.

Qemal Kasaruho, lindur në Gjirokastrë. Ekonomist.

Tefik Shehu, lindur në Gjakovë kishte studiuar për drejtësi dhe ekonomi.

Gjon Temali, lindur në Shkodër, në 1904. Studion për farmaci në Firence.

Fadil Dizdari, lindur në Kavajë. Ishte librashitës.

Petro Konomi, lindur në Kajoro. Studimet e larta në Itali. Punonjësi i ATSH-së, deri në arrestim.

Pandeli Nova, lindur në Opar, në 1892. Merrej me tregti.

Ali Qorraliu, lindur në Tiranë, në 1890.

Ekzekutimi i të marrëve peng është kryer më 26 shkurt 1951.

Dekreti pas atentatit

Vetëm më 25 shkurt 1951, prokurori Siri Çarçani kishte nënshkruar akuzën ndaj personave të rrëmbyer se "ishin vënë në shërbim të agjenturave të huaja, kishin formuar një organizatë terroriste, si dhe kishin propaganduar për të rrëzuar me dhunë pushtetin popullor".

Për të përligjur veprimin e mësipërm, më 26 shkurt 1951, Presidiumi i Kuvendit Popullor nxori dekretin nr.1223, "Mbi ndjekjen dhe shikimin e veprimtarisë së organizatave terroriste dhe të akteve

terroriste kundër punonjësve të pushtetit popullor dhe të organizatave politike e shoqërore të RPSSH-së". Sipas dekretit, ndaj të akuzuarve, hetimet përfundonin brenda 10 ditëve, aktakuza i tregohet të pandehurit një ditë para daljes në gjyq, nuk lejohej rekursi dhe vendimi zbatohet menjëherë.


Më 27 shkurt 1951, dy ditë pas pushkatimit, Gjykata e Lartë Ushtarake, me nënshkrimin e Shuaip Panaritit, ka nënshkruar një vendim dënimi me vdekje.

Organizata "Bashkimi i Kombit" hodhi bombën në ambasadë

Bombën, në të vërtetë, e hodhën Hysen Llulla dhe Qazim Laçi. Këta ishin drejtues të organizatës antikomuniste "Bashkimi i Kombit", e cila kishte lindur pas dyshimit për dekonspirimin e or-

ganizatës tjetër antikomuniste "Fronti i Rezistencës", të cilën e kishte mbërthyer Sigurimi i Shtetit. U arrestuan një muaj pas ngjarjes së bombës, Qazim Laçi, Sejfulla Shima, Rustem Thaçi, Riza Shehu, Zenel Rika dhe Ali Vogli. Hysen Llulla u vra në përpjekje, nga Sigurimi i Shtetit.

Më 29 dhjetor 1951, pas dhënies së vendimit të gjykatës dhe urdhrat të ministrit të Punëve të Brendshme, të dy ditëve më parë, u krye ekzekutimi i personave të përmendur. Sipas procesverbalit të pushkatimit, i cili nuk iu lidh dosjes hetimore – gjyqësore, por është administruar në komunikatën ditore të MPB-së, të dënuarit me vdekje, në fjalën e fundit kanë thirrur për shëndetin e autoriteteve më të larta të Tiranës dhe Moskë.




Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

Komploti kundër Kishës

Shtëpia Botuese 55 sjell për lexuesin një nga librat me të debatuar mbi historinë e Kishës Katolike



Ky libër, historikisht i rëndësishëm, do të sulmohet, me të gjitha mundësitë, si antisemitik. Librin rrefen se, hebrejtë kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm, dhe, jo gjithnjë të dobishëm, në të gjithë historinë e njerëzimit e kjo është e dukshme; që veprimtaria e tyre nuk ka qenë gjithnjë miqësore kundrejt Krishtërit dhe popujve johebrej, është, gjithashtu, e dukshme, dhe ka një fond të jashtëzakonshëm evidencash nga burime judaike e të tjera, të autoritetit të palëkundur, që e provon këtë

Serbët, sërish protagonistë të gjenocideve – mercenarët serbë të luftës në mbrojtje të Gadafit

“Qentë e luftës”, kështu quhet organizata e mercenarëve serbë të luftës, të cilët aktualisht kanë udhëtuar në Libi për të ndihmuar, në këmbim të mijëra dollarëve, liderin libian, Muammar al Gaddafi, për të kryer të vetmen punë që ata dinë të bëjnë më mirë, atë të vrasjes dhe terrorizimit të njerëzve të pafajshëm. Ata kanë dhënë provat për aftësinë e tyre, në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë, dhe tani po nxjerrin mallin e tyre për këto krime ndaj popullit libian. Kjo organizatë, përbën “ajkën” e makinerisë së luftës shfarosëse të Serbisë dhe është një “farë” e keqe por që vazhdon të rritet ende edhe sot, e “mbjellë” nga lideri më famëkeq i Ballkanit, Slobodan Milosheviç

Nga Redi Agolli



“Qentë e Luftës”, (Psi rata në serbisht), kështu janë quajtur mercenarët serbë të luftës, të cilët aktualisht janë punësuar nga lideri libian Gaddafi, për ta mbështetur këtë të fundit, në „gjenocidit“ e tij ndaj popullsisë libiane. Si për ironi të fatit, duhet të themi se Gaddafi është treguar inteligjent në zgjedhjet e tij, sepse për të vrarë dhe terrorizuar njerëz të pafajshëm, nuk mund të gjejsh organizatë më të aftë për të kryer një punë të tillë se sa vetë mercenarët serbë të luftës, ku përfshihen ish-ushtarë, ish-policë dhe ish-anëtarë të “Beretës së Kuqe”, organ i krijuar nga Millosheviç, të cilët kanë dhënë prova për aftësinë e tyre, në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë. Qendra e kësaj organizate mendohet të jetë në periferi të një qyteti të vogël të quajtur, Obrenovac, 30 kilometra larg Beogradit. Përveçse përbëhen nga ish-ushtarë dhe ish-policë, një pjesë e mirë e anëtarëve të saj janë rekrutuar që fëmijë, të cilët janë rrëmbyer nga Bosnja dhe Kroacia, dhe janë stërvitur që në fëmijëri për të shndërruar në „armë“ lufte. Krimet që po kryen Gaddafi kundër popullsisë vendase e ka konstatuar edhe vetë Këshilli i Sigurimit i OKB-së, i cili e ka dënuar ashpër përdorimin e forcës nga ana e Libisë kundër civilëve dhe tha se personat përgjegjës duhet të japin llogari. Ndërkohë, Franca dhe Gjermania kanë kërkuar sanksione të shpejta të Bashkimit Europian kundër Libisë. Këto mund të jenë për ndalimin e udhëtimeve, ngrirjen e pasurive dhe ndërprerjen e përkohshme të marrëdhënieve ekonomike me Libinë. Pas kërcënimit për një goditje të përgjakshme ndaj protestave në Libi nga presidenti Muammar al Gaddafi, situata në vend mbetet e turbullt. Presidenti i parlamentit Mohamed Svei tha në Tripoli se në shumë prej qyteteve të mëdha është vendosur përsëri qetësia. Ambasadori i Libisë në OKB, Ibrahim Dabbaschi paralajmëroi për rrezikun e një gjenocidi dhe raportoi për një dhunë të re në perëndim të vendit. Gaddafi vetë kishte njoftuar më parë se do ta luftonte lëvizjen e protestave. Ai do të vdiste në rast nevojë si „martir“, tha ai në një fjalim në televizionin shtetëror. Gaddafi hodhi poshtë mundësinë e dorëheqjes nga posti. Përfaqësuesit e 15 vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit shprehin shqetësim të thellë dhe keqardhje për shkak të vrasjes së

qindra civilëve, thuhet në kumtesën e organit më të lartë të OKB-së. Ata kërkojnë ndërprerjen e menjëhershme të dhunës dhe që qeveria libiane të përmbushë kërkesat e drejta të popullit. Gjermania dhe vendet e tjera angazhohen që përgjegjësit për dhunën të nxirren para drejtësisë. Takimi i Këshillit të Sigurimit u mbajt me kërkesën e delegacionit të Libisë në OKB. Ministria e Jashtme amerikane Hilari Klinton tha se Uashingtoni është i „alarmuar“ për shkak të situatës, sepse nga Libia kanë arritur informacione për vrasjen dhe plagosjen e qindra njerëzve. Qeveria e Libisë duhet t’i nxjerrë përgjegjësit para drejtësisë dhe t’i japë fund dhunës. Kjo gjakderdhje është absolutisht e papranueshme. Qeveria e Libisë duhet të respektojë të drejtat e popullit të vet, ku bëjnë pjesë edhe e drejta e mendimit dhe e tubimit“, tha ajo. Masa konkrete kundër qeverisë libiane nuk janë ndërmarrë as në Këshillin e Sigurimit dhe as nga qeveria amerikane. Përfaqësuesit e Libisë në OKB kërkuar që të vendoset masa e ndalim-fluturimit, për të pamundësuar që demonstruesit të sulmohen me avionë nga ajri. „Rrugët e komunikimit pothuajse janë ndërprerë tërësisht, por ne po përpiqemi të mbledhim sa më shumë informacione. Kur t’i kemi mbledhur të gjitha informacionet do të bëjmë edhe vlerësimin e tyre“. Por mundësia e Uashingtonit për të vepruar është më e kufizuar se sa në rastin e Egjiptit. Qeveria amerikane e tërhoqi per-

sonelin nga ambasada e vet në Tripoli në vitet 70-të. Raportet mes këtyre vendeve u rivendosën në vitin 2003, pasi Libia u shpreh e gatshme që t’ia dorëzojë SHBA-së planet e veta për armët e shkatërrimit në masë dhe u përjetua se nuk do ta mbështesë terrorizmin dhe mori përgjegjësinë për atentatit në Lockerbie. Në 2006 Uashingtoni e hoqi Libinë nga lista e vendeve që mbështesin terrorizmin. Ndërsa dy vite më vonë u dërgua atje ambasadori amerikan, i cili para pak kohësh është tërhoqur, pas botimit të të dhënave sekrete nga portali i internetit WikiLeaks. As ndihmat amerikane për Libinë nuk janë të mëdha, sepse për këtë vit janë lëvruar vetëm një milion dollarë për forcimin e raporteve ushtarake. Ndërkohë që 85 % e naftës nga ky vend eksportohet në Evropë.

Senatori John Kerry kërkon që kundër Libisë të vendosen sanksione. Ndërsa eksperti Elliott Abrams mendon se qeveria e presidentit Barak Obama duhet të bëjë më shumë kundër Muammar al-Gadafit. „Pse nuk e përjashtojmë nga Këshilli i Sigurimit për të drejtat e njeriut? Pse nuk i ngrijmë të gjitha kontot e Gadafit dhe familjes së tij? Duhet të përpiqemi të vendosim edhe një embargo të armëve, nëse regjimi i atjeshëm përpiket të blejë më shumë armë për t’i përdorur kundër popullit. A i kemi ndërmarrë të gjitha masat e mundshme për të ofruar ndihma humanitare, përmes Egjiptit apo Tunizisë?“

Presidenti francez Nicolas Sarkozy ka kërkuar sanksione të shpejta të Bashkimit Europian kundër Libisë. Këto mund të jenë për ndalimin e udhëtimeve, ngrirjen e pasurive dhe ndërprerjen e përkohshme të marrëdhënieve ekonomike me Libinë, thuhet në një deklaratë të zyrës së presidencës në Paris. Bashkësia ndërkombëtare nuk duhet të shikojë vetëm „shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut“, theksoi Sarkozy. Ndërkohë ministria e Jashtme amerikane Hillary Klinton u shpreh: „Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të vëzhgojnë të alarmuar situatën në Libi. Mendimet dhe lutjet tona janë me ata që kanë humbur jetën dhe të afërmit e tyre, në bashkohemi me komunitetin ndërkombëtar në dënimin e dhunës“. Nisur nga situata në Libi, Këshilli i Sigurimit në Nju Jork i ka kërkuar pushtetmbajtësit Gaddafi që t’i japë fund menjëherë dhunës. Në një deklaratë të përbashkët forumi më i lartë i OKB-së shprehu shqetësimin e tij të thellë për gjendjen në vendin afrikano-verior. Gaddafi duhet ta kuptojë deklaratën si „një sinjal të qartë“ që ai është përgjegjës për mbrojtjen e popullit të tij. Sidoqoftë në Këshillin e Sigurimit nuk u miratua ndonjë rezolutë formale. Për shkak të trazirave, dhjetëra mijëra të huaj janë larguar nga Libia me avionë, anije apo përmes rrugëve tokësore. Me dy avionë të ushtrisë gjermane dhe një avion të posaçëm të shoqërisë ajrore Lufthansa u larguan nga Lib-

ia rreth 350 përfaqësues biznesesh evropiane dhe gjermane. Ende gjenden rreth 250 gjermanë në Libi, tha ministri i Jashtëm gjerman, Guido Westerwelle. Për evakuimin janë planifikuar edhe avionë të tjerë të veçantë. Turqia do të tërheqë me anije deri në 25.000 shtetas të saj, shumë nga prej tyre punëtorë të firmave turke të ndërtimit. Në aksionin e parë ajo tërhoqi 3000 qytetarë e saj nga Bengasi. Greqia ofroi ndihmën e saj për udhëtimin e 15.000 punëtorëve kinezë në rrugë detare.

Tendencë – Ministri i Jashtëm italian, Fratini: 1,000 të vrarë në një javë në Libi/Ministri i Jashtëm italian, Franko Fratini, tha se bazuar në informacionet e ambasadës së Italisë në Tripoli, lideri libian, Muammar Gaddafi, ka humbur kontrollin ndaj provincës lindore Sirenaika. Fratini beson se shifrat për 1,000 të vrarë nga shtypja e protestuesve janë reale. Diplomati italian shprehu shqetësimin se afro 300 mijë imigrantë nga Libia mund të arrijnë në Itali, për shkak të trazirave. „Ne po përballemi me një situatë të rëndë që është bërë edhe më serioze nga fjalimi i mbrëmshëm i Muammar Gaddafi“, tha Fratini. Libia dhe Italia kanë gëzuar marrëdhënie të ngushta tregtare, veçanërisht nga viti 2008 kur dy vendet kanë nënshkruar një traktat miqësie për lehtësimin e investimeve të ndërsjella.

Ish-Ministri libian: Gaddafi urdhëroi masakrën e Lokerbisë/ Ish-Ministri i Drejtësisë në Libi, deklaroi në të përditshmen suedeze „Expressen“, se kolonel Muammar Gaddafi urdhëroi personalisht masakrën e Lokerbisë. Një avion i „Pan Am“-it shpërtheu në ajër mbi fshatin skocez të Lokerbisë, në vitin 1988, duke vrarë 270 persona. I vetmi person i kapur dhe i shpallur fajtor për këtë ngjarje ishte një terrorist libian. Një prej figurave më të rëndësishme të jetës politike libiane në epokën 42-vjeçare të Gaddafi-t, Mustafa Abdel-Jalil, deklaroi: „Kam prova se ishte vetë Gaddafi ai që urdhëroi masakrën e Lokerbisë. Për ta fshehur këtë, ai bëri gjithçka që kishte në dorë për të liru al-Megrahin nga burgu nga mbahej në Skoci (i referohet terroristit të dënuar me burgim të përjetshëm, i liru në 2009-n, pasi ishte në muajt e fundit të jetës, për shkak të një sëmundje të pashërueshme. Çuditërisht, ai është ende gjallë edhe sot). Megjithatë, Abdel-Jalil nuk dha prova specifike për përfshirjen e diktatorit në atë që ishte akti terrorist me më shumë viktime në avioacion, deri në momentin kur ndodhi.

Ka filluar fushata e abonimeve në gazetën "55". Ofertat e abonimeve janë:

1 muaj	900 lekë
3 muaj	2700 lekë
6 muaj	5400 lekë
1 vit	10800 lekë



Të gjithë të interesuarit që duan të abonohen në gazetën "55", të drejtohen pranë:

POSTA SHQIPTARE
AGJENSIA E SHPERNDARJES E
SHTYPIT 1, 2
ADRION LTD

tel : 04/2321364
cel : 0672135242

Qytetarë, biznesmenë, institucione, abonohuni në gazetën "55"!



Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

E VËRTETA E FSHEHUR E NJË PROCESI

E VËRTETA E FSHEHUR E NJË PROCESI



GJYQI I
KOÇI XOXES,
LIDHJET E TIJ
ME ENVER HOXHËN

55

*Shtëpia
Botuese*

Përgatiti: Kastriot Dervishi

Dëshmitë e bashkëpunëtorit të ngushtë të Enver Hoxhës, Koçi Xoxe në hetuesi dhe gjatë procesit gjyqësor. Rrëfimi për veprën e përbashkët të Hoxhës dhe Xoxes mbi shqiptarët, për torturat, ekzekutimet dhe masakrimet e kryera. Marrëdhëniet shqiptaro - jugosllave të viteve 1944 - 1948 parë në këndvështrimin e deklarimeve të ish ministrit të Punëve të Brendshme, Koçi Xoxe, zbatuesit të urdhrave të eprorit të tij Enver Hoxha.

Botimet e reja